

# PERCEPTIMI PUBLIK PËR BE-në NË SHQIPËRI



Albanian Media Institute  
Instituti Shqiptar i Medias

# PERCEPTIMI PUBLIK PËR BE-në NË SHQIPËRI

Prof. Asoc. Dr. Ilir Kalemaj



Albanian Media Institute  
Instituti Shqiptar i Medias

Tiranë, 2022

*Titulli:* Perceptimi publik për BE-në në Shqipëri

*Autor:* Prof. Asoc. Dr. Ilir Kalemaj

Copyright: © ISHM

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

*Tel./fax:* ++ 355 4 2229800

*E-mail:* [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)

# TRANSITION

Transition Promotion Program

Ky botim u realizua nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke. Opiniet e shprehura janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit apo implementuesit të Projektit.

## **Pasqyra e lëndës**

I.	Hyrje .....	5
II.	Historiku dhe perceptimi i rrugëtimit Shqipëri-BE .....	8
III.	Sfidat e brendshme dhe të jashtme të BE-së .....	12
IV.	Kritikat e elitës politike dhe publike në raport me BE-në .....	16
V.	Përfshirja e aktorëve të tretë në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëri .....	29
VI.	Fazat e ndryshme të integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE .....	43
VII.	Përfundime .....	46
VIII.	Referencat .....	49



## I. Hyrje

Marrëdhënia e Shqipërisë me Bashkimin Evropian ka qenë sa e dëshiruar, aq e paarritur, sa aspiratë, aq edhe problematike, sa e testuar, po aq me të panjohurat e saj. Natyrisht çdo qeveri shqiptare, si e spektrit të majtë, ashtu edhe të djathtë, e ka pasur kryeobjektiv strategjik integrimin e Shqipërisë në BE në afate sa më optimale. Fakti që ky proces ka rezultuar sa i dështuar në terma të përgjithshëm, aq i vonuar në afate, ka thelluar skepticizmin e katalizatorëve socialë, të tillë si mediat, grupimet e shoqërisë civile, qytetarët e angazhuar etj.

Përkundrazi, për publikun e gjerë nuk ka alternativë politike të besueshme dhe të dëshiruar që mund të rivalizojë projektin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Gjithashtu ka një retorikë të unifikuar publike rreth këtij projekti (të paktën deri tani), gjë që nuk shkon domosdoshmërisht në të njëjtën linjë me thellimin e skepticizmit për shanset e anëtarësimit real të Shqipërisë në një të ardhme të afërt. Pikërisht për këto arsye edhe në matjet e opinionit publik, për shembull në vitet para-pandemikë 2018 dhe 2019, anketimet tregojnë qartazi një prirje pro-BE. Madje në shumicë relative, me 59% në 2018 dhe 54% në 2019, shqiptarët mendonin asokohe që Shqipëria ishte gati të hapte negociatat respektivisht në qershor të 2019 dhe Mars të 2020-ës.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Albanian Public Perception of the EU. The delegation of the European Union to the Republic of Albania: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/albanian\\_public\\_perception\\_of\\_the\\_eu\\_2019\\_0.pdf?fbclid=IwAR1XqXUvyhGy8jLHuzmb3CiK\\_avrbsly0fcHrH3aS\\_Bg3eKoM7940miE5o](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/albanian_public_perception_of_the_eu_2019_0.pdf?fbclid=IwAR1XqXUvyhGy8jLHuzmb3CiK_avrbsly0fcHrH3aS_Bg3eKoM7940miE5o)

Nga ana tjetër, nuk duhet marrë e mirëqenë që narrativa politike dhe dominimi i ligjërimit politik do të jetë po kaq linear në të ardhmen apo që thellimi i skepticizmit të qytetarëve shqiptarë nuk do të ndodhë nëse BE nuk avancon me negociatat. Ose edhe duke i hapur nuk jep një shpresë në horizont për përmbylljen me sukses të tyre dhe anëtarësimin e plotë. Ky skepticizëm, madje dhe kundërshtimi i projektit të integritit ka ndodhur në të gjitha vendet që janë anëtarësuar nga ish-Evropa Lindore, duke filluar me vendet balltike dhe deri te ato ballkanike. Aktualisht kjo është reflektuar edhe në sondazhet periodike që kryhen për matjen e perceptimit publik për mbështetjen ndaj projektit të integritit evropian në Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Bosnje-Herzegovinë. Gjithashtu edhe në Serbi që ka dhe përqindjen më të lartë të qytetarëve euro-skeptikë. Shqipëria nuk ka një imunitet natyror dhe të përjetshëm ndaj rritjes potenciale të euro-skepticizmit, në rast se procesi nuk ecën në shinat e duhura. Ky studim analizon trendet e perceptimit publik për BE-në në Shqipëri, duke u përqëndruar te ligjërimi i elitave si faktor kyç në matjen e pulsit të opinionit publik në lidhje me integritimin evropian.

Sfidat e jashtme dhe të brendshme të BE-së si agresioni rus kundër Ukrainës, kriza e refugjatëve, rritja e numrit të azilantëve etj., bashkëshoqëruar me mungesën e reformave të vendeve kandidate, mund të ndryshojnë trajektoren e këtyre vendeve drejt integritit në BE. Rritja e skepticizmit nga ana e qytetarëve për shanset e integritit, bashkëshoqëruar me rritjen e dozave kritike nga një pjesë e elitës politike ndaj Brukselit, mund të çojnë në një lodhje ndaj zgjerimit me kah të kundërt. Pra kjo “lodehje nga zgjerimi” që ka pasur gjithnjë vetëm një kah dhe që ishte nga Brukseli drejt rajonit tonë, tashmë ka rrezikun të ketë dy kahe, ndonëse nga vendi në vend risku ndryshon. Shkalla e variacionit përcaktohet nga

alternativat gjeopolitike, nga konteksti historik, social dhe kulturor, nga dominimi i togfjalëshit “integrim evropian” si e vetmja “lojë në qytet” etj.

Ky punim trajton fillimisht historinë e komplikuar të përpjekjeve për integrim të Shqipërisë në BE dhe sesi është perceptuar nga publiku, për të vijuar me sfidat e brendshme dhe të jashtme të vetë BE-së. Mandej trajton rritjen e kritikave të elitës politike dhe publike në Shqipëri në raport me BE-në për të kuptuar nëse kemi të bëjmë me një rritje sistematike dhe strukturore apo thjesht retorikë për konsum të brendshëm. Më pas, punimi argumenton përfshirjen e aktorëve të tretë në Ballkanin Perëndimor, me fokus Shqipërinë në vecanti, duke analizuar rolin dhe impaktin e tyre në marrëdhëniet e këtyre vendeve me BE-në. Në fund, vijon me stadin e ndryshëm të integrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe çfarë leksionesh mund të nxirren nga ky krahasim duke ofruar edhe konkluzionet përkatëse.



## II. Historiku dhe perceptimi i rrugëtimit Shqipëri-BE

Shqipëria ka vendosur marrëdhëniet diplomatike me Komunitetin Ekonomik Evropian në 1991, ndërkohë që në 1992 u nënshkrua Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit dhe kanë filluar përfitimet e para nga Programi PHARE. Kjo lidhje vijoi të konsolidohet deri në 1997, kur Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian miraton përfaqsimin rajonale për vendet e rajonit, me anë të cilës BE përcakton kushtet politike dhe ekonomike për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve. Por fatkeqësisht në po këtë vit, në Shqipëri ishte duke ndodhur *annus horribilis* i politikës shqiptare me rënien e institucioneve dhe kaosin social dhe ekonomik. Pritshmëritë e shoqërisë shqiptare ishin natyrshëm të mëdha për një integrim të shpejtë në BE deri në vitin 1997 kur ndodhi rikthimi në pikën fillestare.

Ndërkohë në 1999 patëm disa zhvillime jo pa rëndësi, që thelluan bashkëpunimin Tiranë-Bruksel, të tilla si procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA), i cili synonte ish-republikat jugosllave që u përfshinë në konfliktin ndëretnik, proces që përfshiu edhe Shqipërinë e cila ishte destabilizuar së brendëshmi. Gjithashtu programi i mëparshëm PHARE u zëvendësua me programin e ri CARDS (Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim). Në të njëjtin vit Shqipëria u përfshi në Regjimin Autonom Preferencial,

ndërkohë që në 2000 produktet nga Shqipëria u përfshinë për herë të parë në hyrjet pa doganë në tregun e BE-së. Në 2001 u krijua grupi Konsultativ BE-Shqipëri.<sup>2</sup>

Ndërkohë që në 2003, u çelën negociatat zyrtare gjatë vizitës së Presidentit të Komisionit Evropian Romano Prodi dhe nisi raundi i parë i negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Nga ana tjetër, lajm madhor ishte Samiti i Selanikut që konfirmoi perspektivën për aderim në BE të vendeve të rajonit, si dhe sigloi Marrëveshjen e Ripranimit Shqipëri/BE.<sup>3</sup> Duhej pritur mandej viti 2006 për siglimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit si dhe Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Gjithashtu në të njëjtin vit, Këshilli miraton një rregullore duke krijuar një instrument të ri për Ndhimën e Para-Anëtarësimin (IPA). Ky instrument i vetëm financiar thjeshtëzon dhe projektin ndihmën e jashtme të BE-së gjatë periudhës së para-anëtarësimin. Ndërkohë në 1 prill 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit.<sup>4</sup> Duhej pritur më pas viti 2010 që të arrihej liberalizimi i vizave për qytetarët e Republikës së Shqipërisë të cilët u pajisën me pasaporta biometrike. Heqja e regjimit të vizave qe dhe shenja më e prekshme e asaj që ofron BE-ja për qytetarët shqiptarë. Ndërkohë u deshën dy vjet të plota pritjeje nga momenti që Komisioni Evropian rekomandoi dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Vetëm në 24 qershor 2014 Këshilli i Ministrave i BE-së miratoi unanimisht rekomandimin e Komisionit.<sup>5</sup>

---

<sup>2</sup> Historiku i marrëdhënieve BE-Shqipëri. Marrë nga: [Historiku i marrëdhënieve BE-Shqipëri \(trt.net.tr\)](http://trt.net.tr) 24.06.2014-08.05.2022

<sup>3</sup> *Ibid*

<sup>4</sup> Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian. MEPJ. Marrë nga: <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

<sup>5</sup> Historiku i marrëdhënieve BE-Shqipëri

Është për t'u nënvizuar fakti i ndryshimeve të perceptimit të shqiptarëve në raport me ecurinë e integritit përgjatë kësaj periudhe. Për shembull, "Perspektiva Europiane e Shqipërisë: Perceptime dhe Realitete 2014" i AIIS, nënvizonte se asokohe 49.1% e shqiptarëve i ishin përgjigjur 'po' mundësisë së marrjes së statusit nga Shqipëria, në muajin qershor, kundrejt 28.3% që ishin përgjigjur 'jo'. Njëkohësisht, për çështjen e mosdhënies së statusit në dhjetor 2013, "37.6% e të anketuarve bëjnë përgjegjëse qeverinë shqiptare; 29.8% partitë politike dhe 13.7% të gjitha qeveritë e BE-së. Studimi i AIIS-së duke krahasuar të dhënat me vitet e shkuara konstaton se mbështetja e shqiptarëve për t'u bërë pjesë e Europës është në rënie. Sipas këtij studimi nëse në vitin 2013 kjo mbështetje ishte 85%, në vitin 2014 është 77%".<sup>6</sup> Ajo që gjenerojmë si gjetje paraprake është se perceptimi i publikut nuk është linear dhe i pakushtëzuar, por është në varësi të përshpejtimit apo ngadalësimit të procesit. Proces ky që ka dy kahe përgjegjshmërie por që në përgjithësi ajo që ka qenë konstante është paaftësia e Shqipërisë për të përmbushur me sukses "detyrat e shtëpisë". Ndaj dhe pjesa më e madhe e të anketuarëve fajësojnë me të drejtë qeverinë dhe partitë politike, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël e sheh problemin te Brukseli. Ky trend skepticizmi dhe rënie e besimit është përforcuar vitet e fundit.

Mandej duhej pritur 25 marsi i 2020-ës që pavarësisht rekomandimit pozitiv të Komisionit, Këshilli Evropian të ri-kushtëzonte hapjen formale të negociatave.<sup>7</sup> Së fundmi,

---

<sup>6</sup> "Studimi i AIIS-së: 49.1% e shqiptarëve 'PO' marrjes së statusit në qershor". 2014. *InfoArkiva: Arkiva Mediatike Shqiptare*. Marrë nga: <http://www.arkivalajmeve.com/Studimi-i-AIIS-se-491-e-shqiptareve-lsquoPOrsquo-marrjes-se-statusit-ne-qershor.1047597194/>

<sup>7</sup> Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. MEPJ. Marrë nga: <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

Këshilli Evropian në mbledhjen e tij të 23 qershorit 2022 nuk vendosi për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Vetoja bullgare për Shkupin u rrëzua formalisht nga parlamenti bullgar vetëm një ditë më pas, pra në 24 qershor. Kjo sipas presidentit Makron është një hap përpara, por jo fitore, ndonëse ishte pikërisht propozimi francez që i hapi rrugë heqjes së vetos.<sup>8</sup> Ndërkohë konferenca e parë ndër-qeveritare Shqipëri-BE dhe hapja zyrtare e negociatave u bë në 19 korrik.<sup>9</sup> Kjo u bë e mundur falë marrëveshjes Sofie-Shkup që u bazua te propozimi francez dhe kalimi nga parlamenti i Maqedonisë së Veriut i kësaj marrëveshje.

---

<sup>8</sup> “Bullgaria heq veton, por BE nuk jep vendim/ Macron: Hap para, por jo fitore”. 2022. *Top Channel*. Marrë nga: <https://top-channel.tv/2022/06/24/bullgaria-heq-veton-por-be-nuk-jep-vendim-macron-hap-para-por-jo-fitore43/> 24 qershor.

<sup>9</sup> “Historike/ Shqipëria çel negociatat! BE: Me Tiranën bëhemi më të plotë! Rama: Evropa fati ynë, vijmë sot këtu pas një pune të gjatë! Integrimi e bën Ballkanin më të mire”. 2022. *Shqiptarja*. 19 korrik. <https://shqiptarja.com/lajm/sot-mbahet-konferenca-e-pare-nderqeveritare-shqiperibe-vrapi-i-fundit-drejt-anetaresimit-te-plate>

### **III. Sfidat e brendshme dhe të jashtme të BE-së**

Nga njëra anë e medaljes, Bashkimi European ka pasur së paku prej 2007-ës sfida të jashtme dhe të brendshme, që kanë tronditur fort disa prej shtyllave ku bazohet ky projekt. Fillimisht kanë qenë cunami i borxheve në Greqi dhe problemet me borxhin në Itali, krizat financiare në Spanjë dhe Portugali, apo avancimi i demokracisë iliberale në Hungari. Këto janë shoqëruar gjithashtu me rritjen e euro-skepticismit që nuk pranon supremacinë e legjislacionit european në Poloni, me sfidën e hapjen se perspektivës europiane për Ukrainën dhe Moldavinë, me ngritjen e mureve që përkojnë me fluksin e refugjatëve azil-kërkuar në BE etj. Disa problematika të tjera të brendshme kanë qenë BREXIT, dobësimi i konkurrencës së BE në tregjet globale, apo ligjërimi anti-emigracion. Së jashtmi, presioni rus që kulminoi me agresionin ndaj Ukrainës, me politikën e shantazhit energjetik apo kondicionalitetit të rrymave të gazit të kushtëzuar së fundmi me politikën e petro-rublave, janë përpjekje të Kremlinit për të zhvlerësuar sanksionet europiane. Gjithashtu rritja e deficitit tregtar me Kinën ngelet një problem i mprehtë.

Nga ana tjetër perceptimi publik dhe mediatik në Evropë dhe që shpesh përcillet dhe në mediat tona është se BE vuan mungesën e një politike koherente edhe së brendshmi. Kjo si rezultat i një kuadri rregullator mjaft të ngarkuar që e pengon

reformimin institucional, konkurrueshmërinë ekonomike si dhe krijon një defiçit demokratik për të cilën BE-ja është kritikuar gjatë veçanërisht në periudhën pas viteve '90. Kjo shumësi ligjesh, direktivash, vendimesh dhe rregulloresh i vështirëson punët imazhit të BE-së nga brenda dhe nga jashtë. Sikundër argumentojnë Heather Grabbe dhe Stefan Lehnne në një artikull të quajtur "Inteligjenca Emocionale për Demokracinë Europiane" dhe të botuar nga Carnegie Europe, "qytetarëve të zakonshëm Europa iu duket e largët, elitiste dhe e vështirë për t'u kuptuar". Ky është më tepër perceptimi sepse në realitet, BE ka më shumë mekanizma transparence se shumica e vendeve anëtare në dispozicion. Gjithashtu ka rentabilitet në shpenzimet buxhetore, ku vetëm 6 përqind e buxhetit të saj shkon për shpenzime administrative. Prapëseprapë perceptimi për Europën është i tillë që shpesh e largon atë nga qytetarët e zakonshëm europianë. Ky perceptim është akoma më i fortë te vendet kandidatë si Shqipëria, për vetë faktin që investimet e BE-së kalojnë kryesisht nga qeveritë shqiptare të cilat vuajnë nga mungesa e llogari-dhënies dhe transparencës.

Rritja e transparencës, korrektimi i "defiçitit demokratik", rritja e rolit të qytetarëve nëpërmjet referendumeve më të shpeshta, rritje e aksesit të tyre në GJED sikundër argumentojnë Grabbe & Lehnne do të mundësonte një Europë më të hapur, më demokratike, me fleksibilitet më të madh, më konkurruese dhe më të drejtë për shumicën e qytetarëve të saj.<sup>10</sup> Kjo vlen si për evropianët e sotëm, ashtu dhe ata të nesërm, duke përfshirë këtu edhe shqiptarët.

Sot perceptimi publik për Bashkimin Evropian,-- edhe në vende që kanë pasur deri vonë një entuziazëm të tepruar për

---

<sup>10</sup> Heather Grabbe and Stephen Lehnne. 2018. "Could an Illiberal Europe Work?" Carnegie Endowment for International Peace.

të si rasti i Shqipërisë,-- është se gjendet e kapërthyer mes krizave të brendshme dhe të jashtme. Këto kriza janë ndër të tjera konflikti Rusi-Ukrainë, problemi me azilantët dhe refugjatët, rënia e fuqisë konsumatore dhe plakja e popullsisë, debati i përhershëm mes prioritetit të thellimit përkundër atij të zgjerimit etj.

Mbi të gjitha politikat e “shkopit dhe karrotës” të BE-së kanë provuar se janë mekanizmi më i mirë për të nxitur përmbushjen me sukses të ciklit tranzicional dhe konsolidimit demokratik të vendeve aspirante, siç demonstrojnë vendet e bllokut të Vishegradit, ato Balltike etj. Edhe në Ballkan ka pasur vazhdimisht “success stories” nga Greqia në vitin 1981, te Sllovenia dhe Kroacia dhe së fundmi Mali i Zi që duket se është përpara fqinjëve të tjerë në përmbushjen e standardeve dhe avancimin në mbylljen me sukses të kapitujve të negociatave. Shqipëria, pavarësisht predispozitave që i kishte qysh në nisje më mira se disa nga fqinjët e ish-Jugosllavisë që u kapën në rrjetën e luftimeve ndërretnike, e ka humbur disa herë trenin e radhës. Duke qenë se marrëdhënia me BE, përveçse simbiotike, i shëmbëllen edhe një tangoje ku hapat shkojnë para dhe mbrapa në varësi të plotësimit të “detyrave të shtëpisë”, ka ardhur koha që Shqipëria të përmbushë me vepra dhe jo me fjalë detyrimet kontraktuale, por edhe reformat e brendshme strukturore dhe institucionale për t’u bërë pjesë e bllokut të vendeve anëtare, e shumta për një dekadë.

Disa nga detyrimet kontraktuale më të rëndësishme në rastin e Shqipërisë, janë ato që përsëriten jo pa shkak në progres-raportet periodike të Komisionit dhe që kanë të bëjnë me depolitizimin e administratës publike, me respektimin e të drejtave pronësore, me reformën në drejtësi, me luftën ndaj krimit të organizuar dhe luftën kundër korrupsionit. Të gjitha këto e vonojnë trenin e integritit dhe konsolidimin

demokratik të vendit. Ky është një perceptim që matet indirekt nga një shumësi analizash dhe debatesh mediatikë. Por njëkohësisht reflektohet edhe direkt te perceptimi i qytetarëve i matur përmes indekseve ndërkombëtare si Transparency International për korrupsionin<sup>11</sup> apo sondazhet e IDM për besimin në qeverisje.<sup>12</sup>

---

<sup>11</sup> Shqipëria ka rënë në vend të 110 nga 180 shtete në vitin 2021. Shih për më gjerë: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

<sup>12</sup> “Sondazh i opinionit publik: Besimi në qeverisje.” 2016. IDM. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2016-AL.pdf>



## IV. Kritikat e elitës politike dhe publike në raport me BE-në

### a. Skepticizmi për vaksinat

Çështja e mos-sigurimit të vaksinave Pfizer, Moderna apo Astra-Zeneca në fazën e parë të emergjencës së COVID 19, për të cilat pritej ndër të tjera ndihma e BE-së për t'i siguruar, shtoi kritikrat publike ndaj Brukselit në Shqipëri. Për shembull, vetë kryeministri Rama ka përdorur një gjuhë që i tejkaloi kufijtë diplomatikë, me kritikizmin e hapur ndaj Brukselit në kulmin e krizës pandemike. Ai është shprehur asokohe *inter alia* se: “BE ka marrë një vendim fatkeq. Kjo sepse ka vendosur që vetëm tepricat t’i dërgoheshin vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë që nuk ka teprica këtu. Ka më pak sesa është prodhuar”.<sup>13</sup> Ai vazhdoi të përdorte një gjuhë edhe më të ashpër ndaj Brukselit kur e kritikoi për lënien jashtë qëllimisht të shpërndarjes së vaksinave për Kosovën duke u shprehur në mënyrë befasuese se “si njeri jam ndjerë i indinjuar dhe si european jam ndjerë i turpëruar, ndërsa si kryeministër i Shqipërisë jam ndjerë më i motivuar se kurrë për të mos lejuar që shqiptarët të ndjehen

---

<sup>13</sup> Bledar Qalliu. 2020. “Rama Blames the EU for Albania’s Lack of Covid-19 Vaccine”. *Exit News*. [Rama Blames the EU for Albania’s Lack of Covid-19 Vaccine - Exit - Explaining Albania](#)

të përjashtuar nga mundësia për t'u mbrojtur njëkohësisht me europianët e tjerë në këtë luftë botërore me rrezikun e vdekjes".<sup>14</sup>

Këto deklaratat asokohe morën dhe vëmendjen e mediave botërore duke bërë që të theksohej dukuria e re e euro-skepticitizmit të elitave drejtuese në Shqipëri, një vend që nga ana tjetër ka një nga popullsitë më euro-entuziaste jo vetëm në rajon, por edhe në krejt ish-Evropën Lindore. Për shembull, agjencia e lajmeve italiane ANSAMed thekson se "Kryeministri shqiptar kritikoi Bashkimin Evropian dhe vendimin e tij për të lënë jashtë planit të vaksinimit vendet e Ballkanit Perëndimor".<sup>15</sup> Rama tha se "është e papranueshme jo vetëm moralisht dhe politikisht, por e pajustificueshme edhe nga pikëpamja logjike, duke qenë se ka vende që mbajnë doza shtesë sepse nuk janë në gjendje të veprojnë shpejt".<sup>16</sup> AFP citoi gjithashtu Ramën të thoshte: "Kur BE-ja filloi të shpërndante dozat më 27 dhjetor, ajo mund t'u kishte dhënë menjëherë akses edhe vendeve të Ballkanit Perëndimor jashtë BE-së që të kishin të paktën disa doza për të vaksinuar linjat e tyre të para...Por ata nuk e bënë".<sup>17</sup> Gjithsesi kryeministri Rama, pavarësisht këtyre deklaratave refuzoi të merrte vaksinat Sputnik nga Moska, e cila ndërkohë kishte

---

<sup>14</sup> "Vaksina anti-Covid edhe për Kosovën"/ Rama i indinjuar me BE-në: Si europian jam ndjerë i turpëruar, vendimarrje absurde dhe e papranueshme..." 1 Janar 2021. Panorama nëspaper: "[Vaksina anti-Covid edhe për Kosovën](#)"/ Rama i indinjuar me BE-në: Si europian jam ndjerë i turpëruar, vendimarrje absurde dhe e papranueshme... (panorama.com.al)

<sup>15</sup> "Covid: first vaccinations in Albania, Rama criticizes EU." ANSAMed 11 Janar 2021. Marrë nga:[Covid: first vaccinations in Albania, Rama criticizes EU - Politics - ANSAMed.it](#)

<sup>16</sup> *Ibid*

<sup>17</sup> "Albania starts Covid-19 vaccinations as PM blasts slow EU help". AFP. 11.01.2021. Marrë nga:[Albania starts Covid-19 vaccinations as PM blasts slow EU help - France 24](#)

furnizuar Beogradin me rreth një milionë të tilla. Këto doza të rritjes së pakënaqësisë së Ramës ndaj Brukselit nuk kaluan pa vëmendje dhe morën kritika dhe në shtypin vendas.<sup>18</sup>

## **b. Skepticizmi për vonesat në procesin e integrimit**

Nga ana tjetër, ka pasur pak raste të tjera ku kryeministri, qeveria në tërësi apo opozita të jenë shprehur haptazi skeptikë në lidhje me BE-në. Më tepër janë shfaqur skeptikë në lidhje me mundësitë e zgjerimit, pavarësisht se në rastin e Shqipërisë, gjithmonë nënkuptimi ka qenë që nuk ka ndonjë rrugë tjetër alternative. Kryeministri Rama për shembull e ka krahasuar ndonjëherë procesin e integrimit me përvojën e të mbeturit vazhdimisht në këmbë në altar. “Zgjerimi nuk ka ngecur - ai është ndalur,” është ankuar ai në ndonjë rast. Basti mbi Evropën po bëhet gjithnjë e më shumë një detyrim për votuesit e lodhur të lodhur duke dëgjuar për premtime të paplotësuara.<sup>19</sup>

Nga ana tjetër, Genc Pollo, ish-ministër dhe deputet i opozitës shkruan ndër të tjera se: “Përvoja e viteve të fundit në Shqipëri njihet arritje reale si ndihma europiane për arritjen e Marrëveshjes për Dekriminalizimin (2014) apo Reformën Zgjedhore (2020); po kështu mund të shënohen dështime

---

<sup>18</sup> Alfons Rakaj. 2021. “Vrapimi në drejtim të gabuar: Pakënaqësia e Ramës nga BE-ja në lidhje me vaksinimin është rezultat i nervozës në rritje”. *Sbunker*. 8 shkurt. Marrë nga: <https://sbunker.net/histori-nga-rajoni-3-blllogje-tematike/90818/vrapimi-ne-drejtme-te-gabuar-pakenaqesia-e-rames-nga-be-ja-ne-lidhje-me-vaksinimin-eshte-rezultat-i-nervozes-ne-rritje/>

<sup>19</sup> Benjamin Haddad and Damir Marusic. 2021. The Balkans Don't Believe the EU Anymore.” *Foreign Policy*. 25 gusht. Marrë nga: <https://foreignpolicy.com/2021/08/25/balkans-dont-believe-eu-anymore-albania-macedonia-rama-vucic/>

si heshtja për Tahir-Kanabizmin (2016) apo deklarimet pro nismës abuzive të shkatërrimit të Teatrit Kombëtar (2019) nga zyrtarë të caktuar të Komisionit European. Pa folur më tej për gjeeste të pamenduara si organizmi i “Vrapit kundër korrupsionit” (2020) ku diplomatë europianë fugonin të qeshur krahas ministrave problematikë përgjatë bregliqenit në Tiranë. Gjest që u shpotit me të drejtë nga opinioni publik.”<sup>20</sup> Ose siç shkruan Akri Çipa per Euraktiv: “Zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor është shënuar nga pengesa të vazhdueshme dhe vonesa të pajustificuara. Dritarja e mundësive të rajonit mund të mbyllet së shpejti, një tjetër vonesë mund t’i japë një goditje vdekjeprurëse procesit të zgjerimit dhe kjo është arsyeja pse BE-ja nuk duhet të injorojë progresin e Shqipërisë”.<sup>21</sup> Edhe një artikull tjetër i ditëve të fundit theksonte *inter alia* se: “ndërsa ka probleme të konsiderueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë korrupsionin, keqfunksionimin e pushtetit gjyqësor, madje edhe kapjen e drejtpërdrejtë të shtetit (gjëra që janë të pranishme edhe në treshen e vendeve lindore që aspirojnë të anëtarësohen në BE), e vërteta është se një arsye tjetër pse ky rajon nuk është tashmë në BE është sepse shumë në Union nuk janë veçanërisht entuziastë për integrimin e tyre në radhë të parë. Më pak se një vit më parë, disa vende anëtare të BE-së vunë në dyshim vendosjen e fjalës “zgjerim” në deklaratën e samitit të fundit të Ballkanit Perëndimor”.<sup>22</sup> Gjithashtu gjuha

---

<sup>20</sup> Genc Pollo. “Procesi apo rezultati?” *Gazeta Panorama*. 12 Prill. Marrë nga: [Procesi apo rezultati? \(panorama.com.al\)](http://panorama.com.al)

<sup>21</sup> Akri Cipa. 2021. “The EU should resist moves to halt Balkan enlargement.” May 18. *Euraktiv*. Marrë nga: [The EU should resist moves to halt Balkan enlargement – EURACTIV.com](http://euractiv.com)

<sup>22</sup> “ANALIZA: E vërteta e planit “pa ndjenja” të Macronit mbi zgjerimin e BE-së”. *Gazeta Tema*. 27 Maj 2022. Marrë nga: <https://www.gazetatema.net/bota/analiza-e-verteta-e-planit-pa-ndjenja-te-macronit-mbi-zgjerimin-e-be-se-i340336>

e përdorur nga kryeministri Rama nuk u përcoll aspak mirë dhe nga përfaqësuesit e BE-së, si ambasadori Soreca.<sup>23</sup>

### c. Skepticizmi për idenë e Komunitetit Politik Evropian

Kryeministri Rama ka qenë i pari kryeministër në rajon që e ka përshëndetur idenë e presidentit Macron të Komunitetit Politik Evropian.<sup>24</sup> Këtë gjë e ka përsëritur edhe në prononcimet për mediat ndërkombëtare, si për shembull kur shprehet për median holandeze 'Volkskrant' se është mbështetës i madh i kësaj ideje.<sup>25</sup> Por ndërsa vetë z. Rama ka qenë mbështetës i kësaj ideje qysh në krye të herës, të tjerë politikanë dhe publicistë kanë qenë skeptikë. Për shembull, sikundër argumenton Genc Pollo së fundmi në një shkrim me nota kritike ndaj konceptit: "Statusi Anëtar i Asociuar është degradim politik i Statusit Anëtar i Plotë.... Sipas këtij koncepti Shqipëria mund të ketë akses në sektorë të caktuar të Tregut të Përbashkët Evropian si dhe në disa programe ekonomike të mbështetura nga fondet e kohezionit. Deri tani vetëm anëtarët e plotë kishin akses të pakufizuar; ndërsa shtetet aspirante nuk kishin fare akses deri në momentin që bëheshin Anëtarë të Plotë. Pra kemi

---

<sup>23</sup> Soreca: I habitur nga kritikak e Ramës ndaj BE-së për vaksinën. 2021. A2. 12 janar. Marrë nga: <https://a2news.com/2021/01/12/soreca-per-zerin-e-amerikes-i-habitu-nga-kritikat-e-rames-per-vaksinen/>

<sup>24</sup> "Rama zbardh fjalimin që mbajti dje në samitin e Brukselit: Në Shqipëri, të gjithë i besojnë Europës! Mos lini që ky besim të bjerret pa kthim". *Shqiptarja*. 24 qershor. Marrë nga: <https://shqiptarja.com/lajm/rama-zbardh-fjalimin-qe-mbajti-dje-ne-samitin-e-brukselit>

<sup>25</sup> "Rama për median holandeze: BE-ja ka humbur dy kriza pa bërë asnjë hap përpara". 2022. *Boldnews*. 6 korrik. Marrë nga: <https://boldnews.al/2022/07/06/rama-per-median-holandeze-be-ja-ka-humbur-dy-kriza-pa-bere-asnje-hap-perpara/>

një zgjidhje të ndërmjetme”.<sup>26</sup>Me pak fjalë, Shqipëria do të përfitonte nga fondet për zhvillimin e rajonit dhe të mirat e tregut të përbashkët por nuk do të kishte përfaqësim politik në Bruksel, anëtarë të zgjedhur në Parlamentit Evropian etj.

Gjithashtu, të tjerë janë shprehur edhe më kritikë me turet e fundit të lidërshiptit të BE-së si vizitat rajonale të presidentit Michels, duke i quajtur ato më shumë fushatë lobuese për idenë e Macron-it sesa si benefit për vetë integrimin e shpejtë rajonal. Sikundër shprehet Leonidha Mërtiri së fundmi në një analizë të tij, “Rezultati...? Përsëri ecejake dhe përsëri kurrfarë progresi. Perspektiva europiane vazhdon të përflitet në këto ecejake. E megjithatë, vonesat e reja rritin zgjatimin e tyre. Këto ecejake, dyndur vazhdimisht me inflacion premtimesh, vetëm e kanë zbehur, madje nënvleftësuar misionin e tyre”.<sup>27</sup> Natyrisht vonesat në proces dhe gjuha shpeshherë jo e drejtëpërdrejtë që kanë zgjedhur të shprehen funksionarët e lartë të BE-së të cilët kanë dhe presionin e vendeve anëtare që janë duke u ballafaquar me sfida të ndryshme, kanë çuar në rritje të artikullimit publik të tezave të tilla.

Nota kritike ka pasur së fundmi edhe ish-Ministri i Jashtëm dhe për Europën Ditmir Bushati ku në një analizë për Friedrich Ebert Stiftung ka hedhur në diskutim pyetjen e rëndësishme: “A është Komuniteti Politik Evropian një çmim ngushëllues për shtete që nuk do të antarësohen dot në BE apo një hap drejt antarësimit të plotë?”<sup>28</sup> Gjithashtu ai ngre

---

<sup>26</sup> Genc Pollo. 2022. “Sërish për Shqipërinë në Evropë, por në rrethana të ndryshuara”. *Gazeta Panorama*. 30 Maj. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/1168112-2/>

<sup>27</sup> Leonidha Mërtiri. 2022. “Rezultate apo thjesht ecejake”. *Gazeta Panorama*. 11 Qershor. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/rezultate-apo-thjesht-ecejake/>

<sup>28</sup> Ditmir Bushati. 2022. “Zgjimi Evropian”. Riprodhuar nga gazeta *Panorama*. 6 qershor. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/zgjimi-europian/>

një tezë të rëndësishme kur nënvizon se antarësimi i plotë në bllok i vendeve në ish-Jugosllavi do të përmyllte procesin e rimëkëmbjes pas luftërave në ish-Jugosllavi në këtë rajon të trazuar dhe njëherazi do të shërbente si garanci për Ukrainën në të ardhmen.<sup>29</sup> Ndonëse këtu shtrohet pikëpyetja pse Shqipëria duhet bërë bashkë në një proces me vende që kanë instiguar luftërat në ish-Jugosllavi apo kanë qenë direkt të përfshira në to. Po ashtu ky është çënim i parimit të regatës ku cdo vend duhet të vlerësohet sipas meritës individuale. Në anën tjetër konsiderimi i elementëve gjeopolitikë të tanishëm kur vende që janë antarësuar në NATO si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nuk mund të kenë të njëjtin stad integrimi me vende që kanë deklaruar neutralitet ose janë kundër antarësimit në strukturën euro-atlantike si Serbia apo e kanë objektivisht të pamundur antarësimin në kohë të shkurtër si Bosnja-Herzegovina dhe Kosova. Ndërkohë që një nga premisat e shkrimit në fjalë ishte se anëtarësimi në NATO përgjithësisht shërben si një *conditio sine qua non* që i paraprin antarësimit në BE.

Në përgjithësi, prirja e përgjithshme që vërehet është që qeveria vonesat në procesin e integritit përgjithësisht ua lë faktorëve të jashtëm, si sfidat e vetë BE-së, lodhja nga zgjerimi apo së fundmi konflikti bullgaro-maqedonas i cili mbante peng hapjen e negociatave edhe me Shqipërinë, ndërsa faktorët opozitarë bëjnë rregullisht me faj qeverinë shqiptare për mospërbushje të kushteve, ndërsa ja heqin përgjegjësinë Brukselit për çfarëdolloj vonese. Retorika politike në drejtim të Brukselit ndonjëherë është e hidhur sikundër demonstroi rasti i samitit të Ohrit ku në takimin e radhës të Ballkanit të Hapur” kryeministri Rama shprehet se: “Ne nuk përgatitemi më për dasmën, pasi nuk kemi ndërmend që ne të shkojmë

---

<sup>29</sup> *Ibid*

për dasëm, dhe të na thotë nusja, që në rastin konkret është BE, që nuk ua marrim dhëndërrin. E kuptoni tani, na ka dalë Bullgaria, që është për vete burrë, me njëmijë probleme, po s'kemi çfarë të bëjmë. Kur shkoj sot në Bruksel dhe kur i shoh më vjen shume keq për ta, mundohem t'u jap kurajo, edhe pse më përpara më dukej sikur ishin yje që më jepnin kurajo".<sup>30</sup>

Ndonjëherë prononcimet kanë qenë për medime ndërkombëtare prestigjioze si Financial Times, ku kryeministri Rama është shprehur se: "Brukseli po vuan nga njëfarë amnezie se kush janë ata, cili është qëllimi i ekzistencës së tyre,"<sup>31</sup> ndonëse duke shtuar për ta zbutur disi kritikizmin e fortë se "Ata [BE] janë forca më e madhe për njerëzimin e mirë që ka krijuar dhe shpresoj se do të shërohen shpejt sepse pa ata bota është një vend shumë më i keq."<sup>32</sup> Megjithatë në përgjithësi nuk mund të themi me siguri që këto qëndrime përbëjnë trend dominues të euroskepticizmit ose së paku të kritikës së procesit të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor apo raporteve të përvitshme të Komisionit Evropian, por që gjithsesi paraqesin një ndyshim në krahasim me një dekadë e më parë ku shkrime apo komente të tilla nga elita politike dhe mediatike ishin fort të rralla, për mos të thënë krejt të munguara.

---

<sup>30</sup> "Open Balkan", Rama tallet me BE: Më vjen keq kur i shoh në Bruksel, i jap kurajo". *Boldnews*. 8 Qershor. Marrë nga: <https://boldnews.al/2022/06/08/open-balkan-rama-tallet-me-be-me-vjen-keq-kur-i-shoh-ne-bruksel-i-jap-kurajo/>

<sup>31</sup> "European Union Has Forgotten the Purpose of Its Existence, Rama Tells FT". *Exit.al*. Marrë nga: <https://exit.al/en/2021/05/13/european-union-has-forgotten-the-purpose-of-its-existence-rama-tells-ft/>

<sup>32</sup> *Ibid*



#### **d. Kriticizmi për vendimin e Këshillit Evropian të qershorit 2022**

Kryeministri Rama përdori një gjuhë të ashpër ndaj Bullgarisë duke u shprehur: “Është një ditë e re në Evropë, por jo në Bullgari! Sa turp për Evropën kjo çështje bullgare! Në mes të një lufte shumë të nxehtë në oborrin e pasmë të Evropës, një vend i NATO-s mban peng dy vende të tjera të NATO-s nën mbikëqyrjen e 26 vendeve të BE-së që qëndrojnë të qetë në një shfaqje të frikshme impotence”.<sup>33</sup>Këtë lloj gjuhe Rama e përsëriti sërish, në një intervistë për televizionin Kanal 5 të Shkupit në të cilën vijon të shprehet me tone kritike ndaj Brukselit. Ai shprehet ndër të tjera: “Por në të njëjtën kohë mund t’ju them se ndodhi çfarë ndodhi në sensin që Bullgaria është anëtare e BE-së, BE-ja ka një mënyrë të adresimit të gjërave që është shndërruar në një lloj pengmarrje e vendeve për interesin e një vendi apo të një tjetri dhe gjithashtu fryma e zgjerimit është shtrembëruar disi”.<sup>34</sup> Ky lloj ligjërimi i kryeministrit shqiptar duket që tashmë është kthyer në dominues në retorikën që ai përdor ndaj Bashkimit Evropian. Ngelet për t’u parë nëse ky lloj ligjërimi do të përvetësohet nga pjesa tjetër e qeverisë dhe politikës apo do të ngelet sporadik, i përdorur kryesisht në mënyrë taktike nga kryeministri. Por ka pasur edhe gazetarë dhe analistë që e kanë ndarë këtë optikë të kryeministrit. Për shembull, Skënder Minxhozi shkruan se:

---

<sup>33</sup> “Edi Rama nuk përmbahet para Samitit të BE: Turp për Evropën, që është kaq impotente para Bullgarisë”. 2022. *Gazeta Tema*. 23 Qershor. Marrë nga:<https://www.gazetatema.net/politika/edi-rama-nuk-permbahet-para-samitit-te-be-turp-per-evropen-qe-eshte-kaq-i344062>

<sup>34</sup> “Mos e bëni”/ Rama i vendosur të kërkojë ndarjen nga Maqedonia e Veriut nëse nuk pranohet propozimi i Macron: Dera e BE duhet të hapet”. *Gazeta Panorama*. 4 korrik. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/mos-e-beni-rama-i-vendosur-te-kerkoje-ndarjen-nga-maqedonia-e-veriut-nese-nuk-pranohet-propozimi-i-macron-dera-e-be-duhet-te-hapet/>

“Për herë të parë në vitin 2020, dëshira e shqiptarëve për t’u integruar në Bashkimin Evropain ra poshtë shifrës 90%. Një kampion e vogël alarmi për një proces që zgjat prej kohësh që tashmë nuk mbahen mend dhe që Brukseli prej kohësh e ka futur në logjikën e shtyrjeve pa afat. Mbajtja në fuqi e logjikës së “çifteve” bën që problemet e njërit prej vendeve të jenë njëkohësisht edhe problemet e shtetit tjetër, megjithëse ky i fundit mund të mos ketë asnjë lidhje me to. Siç është rasti aktual i krizës maqedono-bullgare. Të vjen të thuash se po na mbajnë bashkë, që të na lenë jashtë...”<sup>35</sup>

Nga ana tjetër, disa gazetarë dhe opinionistë janë shprehur tërësisht kundër gjuhës së përdorur nga kryeministri Rama. Për shembull, Enver Robelli është shprehur fort në një artikull të publikuar në gazetën Tema ndaj gjuhës së kryeministrit Rama ndaj Bullgarisë dhe BE-së.<sup>36</sup>Të tjerë, si për shembull gazetari Mero Baze kanë nënvizuar rreziqet që i kërcënohen Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor nga hezitimi i BE-së, çka sipas tij mund të promovonte “paqëndrueshmërinë demokratike, linjat pro ruse dhe pse jo autokracitë”.<sup>37</sup>Ndërsa të tjerë gazetarë si për shembull Arbër Hitaj kanë mbështetur mundësinë e ndarjes nga Maqedonia e Veriut që është përmendur si opsioni më i mundshëm dhe nga kryeministri Rama.<sup>38</sup> Kjo ndarje (ang. decoupling), do të vazhdojë edhe pas

---

<sup>35</sup> Skënder Minxhozi. 2022. “Çifti i çuditshëm shqiptaro-maqedon/ Na duan bashkë që të na lenë jashtë?!” *Transition Promotion Program. Instituti Shqiptar i Medias.* <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

<sup>36</sup> “Gjuha e pavend e Edi Ramës kundër Bullgarisë”. 2022. *Gazeta Tema.* 23 Qershor. Marrë nga:<https://www.gazetatema.net/blogu-tema/gjuha-e-pavend-e-edi-rames-kunder-bullgarise-i344074>

<sup>37</sup> Mero Baze. 2022. “Rreziqet nga hezitimi evropian për Ballkanin”. *Gazeta Tema.* 23 Qershor. Marrë nga:<https://www.gazetatema.net/editorial/rreziqet-nga-hezitimi-evropian-per-ballkanin-i344180>

<sup>38</sup> “Përse Shqipëria nuk po ndahet nga Maqedonia e Veriut?” 2022. *Shqiptarja.* 26 Qershor. Marrë nga:<https://shqiptarja.com/lajm/perse-shqiperia-nuk-po-ndahet-nga-maqedonia-e-veriut>

hapjes formale të negociatave me kushtëzimin e Konferencës së Dytë Ndër-Qeveritare me amendamentet kushtetuese që priten nga parlamenti veri-maqedonas.

Konferenca e parë ndër-qeveritare ishte një lajm i shkëlqyer për Shqipërinë, por që gjithsesi ka lënë vend për rezerva. Siç shprehet gazetari Lutfi Dervishi: “Hapja e shumëpritur e negociatave nuk është momenti për shampanjë. Medaljet nuk jepen kur je në hapin e parë të maratonës, por kur mbërrin në finish. Shampanjën e hapjes së negociatave e kemi konsumuar një herë më 2018. Është momenti për të menduar se si do të shkohet deri në fund të kapitullit 33”!<sup>39</sup>Këtë skepticizëm e ka ndarë dhe politologu Ilir Kalemaj i cili ka komentuar në MCN Tv lidhur me Konferencën e parë Ndërqeveritare për të cilën u shpreh se “ky është fillimi i një rrugëtimi të gjatë, ku na presin ende punë të mëdha dhe sfida përpara. Ai tha se nuk është plotësuar asnjë nga kushtet përfundimisht dhe se qeveria ka ende punë në plotësimin e detyrave të saj të shtëpisë”.<sup>40</sup> Ka nga ata që janë edhe më skeptikë në lidhje me perspektivën e antarësimit të Shqipërisë. Një shembull është studiuesi Blendi Kajsio i cili shprehet se antarësimi i pritshëm në BE mund të perceptohet si rrezik për demokracinë shqiptare duke i'u referuar dhe precedentëve të vendeve si Hungaria dhe Polonia të cilat bënë regres pas hyrjes në BE.<sup>41</sup>Ndërkohë

---

<sup>39</sup> Lutfi Dervishi. 2022. “Hapja e negociatave, maratona e radhës drejt BE”. *Panorama*. 19 korrik. <http://www.panorama.com.al/hapja-e-negotiatave-maratona-e-radhes-drejt-be/>

<sup>40</sup> “Negociatat/ Kalemaj: Jam skeptik nuk jemi gati, asnjë kusht i përmbushur plotëisht”. 2022. *MCN Tv*. 19 korrik. <http://www.mcntv.al/2022/07/19/negotiatat-kalemaj-jam-skeptik-nuk-jemi-gati-asnj-kusht-i-p-rmbushur-plot-sisht?fbclid=IwAR24ODWH4G0gGcGlfhyZgn0tW4XJr-Ferdq1UfzZ7Mo9A8FaakJlz-JENNA>

<sup>41</sup> Blendi Kajsio. 2022. “Antarësimi në BE si rrezik për demokracinë shqiptare”. *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedias.org/transition-promotion-program/>

të tjerë publicistë nuk e ndajnë këtë skepticizëm dhe kërkojnë që të rikuperohet koha e humbur dhe integrimi sa më i shpejtë në BE të jetë pikësynimi kryesor.<sup>42</sup>

Por hapja e negociatave është ogur i mirë dhe për faktin se do ta detyrojë politikën shqiptare të vetë-reformohet dhe i heq një pjesë të mirë të diskrecionit.<sup>43</sup> Sikundër shprehet dhe publicisti Prec Zogaj, “më mirë nën regjimin e rreptë të normave dhe arritjeve standarde europiane se sa nën të ashtuquajturin “sovrinizëm” të reklamuar nga një skotë bajraktarësh politikë që kanë sunduar e sundojnë duke shkatërruar zgjedhjet e lira, sundimin e ligjit, qarkullimin e elitave, trasparencën dhe llogaridhënien”.<sup>44</sup> Topi tashmë është në derë të vetë këtyre vendeve, duke filluar me Malin e Zi dhe Serbinë që janë përpara në proces dhe duke vijuar me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. E thënë me fjalë të tjera, secili vend do të vazhdojë të gjykohet bazuar në realizimin e “detyrave të shtëpisë”, ndonëse faktorët gjeopolitikë si kërcënim i rus, mund të detyrojë Brukselin të marrë një vendim politik për të përshpejtuar procesin e integritit të plotë të gjashtëshes.<sup>45</sup>

---

<sup>42</sup> Geron Kamberi. 2022. “Në kërkim të kohës së (pa)humbur të integritit në BE”. *Transition Promotion Program. Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

<sup>43</sup> Mero Baze. 2022. “Çelja e negociatave, ua heq Shqipërinë nga duart politikanëve shqiptarë”. *Gazeta Tema*. 19 korrik. <https://www.gazetatema.net/editorial/elja-e-negociatave-ua-heq-shqiperine-nga-duart-politikaneve-shqiptare-i347711>

<sup>44</sup> Prec Zogaj. 2022. “Fundi i një frustrimi, fillimi i një ere të re”. *Transition Promotion Program. Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

<sup>45</sup> Ilir Kalemaj. 2022. “Ballkani Perëndimor i disa shpejtësive”. *Transition Promotion Program. Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Efektet e shumëfishta të zvarritjes së procesit të integritimit dhe mosnismjes së negociatave deri tani, kanë prekur thuhet se çdo sferë të jetës politike, ekonomike, sociale dhe ndërkombëtare të Shqipërisë. Efekti i përmbledhur i gjithë sa u tha më sipër shfaqet tek emigracioni i lartë nga Shqipëria drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Pas tridhjetë vitesh në pritje, njerëzit e kanë marrë vetë në dorë integrimin duke e kërkuar në vendet e BE-së atë që BE-ja ka premtuar dhe premtonte se do e krijojë në Shqipëri pikërisht përmes procesit të integritimit dhe përafrimit me BE-në.<sup>46</sup> Ngelet për t'u parë nëse hapja e negociatave do të përmisojë ndjeshëm implementimin e legjislativës, konsolidojë shtetin e së drejtës, duke frenuar korrupsionin dhe ndalë dallgën e emigrimit.

---

<sup>46</sup> Ledion Krisafi. 2022. "Efektet e shumëfishta të zvarritjes së procesit të integritimit". *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

## **V. Përfshirja e aktorëve të tretë në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëri**

### **a. Rusia**

Tentativat e Ruisë për hegjemoni në ish-Republikat Sovjetike, ndonëse kanë kulminuar me përpjekjet për pushtimin e Ukrainës, nuk janë të kufizuara në atë rajon. Gjithnjë e më tepër Rusia po përplaset me Perëndimin për dominim edhe në Lindjen e Mesme, në Afrikën Veriore, por sidomos në Ballkanin Perëndimor. Shembujt e ndërhyrjes së Ruisë në rajonin tonë përgjatë viteve të fundit janë të shumtë, në mënyrë të veçantë në Serbi dhe në Bosnjë .

Organizatat pro-ruse në Serbi përfshijnë Partinë Radikale, Partinë Demokratike të Serbisë (DPS) dhe lëvizjen “Dveri”. Ndërsa grupet ultranacionaliste si Zavetnici, Cossacks Ballkanik dhe “Ujqërit e Natës”, shpesh mblidhen nga Shtëpia Ruse në Beograd, një agjenci e Agjencisë Federale të Ruisë. Disa vite më parë, Ministri i Jashtëm rus Lavrov u takua me anëtarët e organizatës pro-ruse Zavetnici, nga radhët e të cilëve u rekrutuan pjesëmarrësit në puçin e Malit të Zi. Në vitin 2012, Rusia gjithashtu krijoi një qendër reagimi humanitar në Niš në Serbinë jugore në afërsi të kufijve të Maqedonisë, Bullgarisë, Kosovës dhe Malit të Zi, ku mbështeste dhe një milici të quajtur Nderi Serb. Gjithashtu, Rusia është e përfshirë në mbështetjen e organizatave të caktuara në Ballkanin Perëndimor, si për shembull Fronti i Demokracisë i

Malit të Zi ose partia opozitare VMRO-DPMNE e Maqedonisë. Moska gjithashtu trajnon dhe organizon grupe paramilitare lokale, një “traditë” që daton në fillim të viteve 1990, kur “vullnetarët” rusë, zakonisht të mbikqyrur nga shërbimet ruse, arritën në ish-Jugosllavi për të luftuar në anën serbe. Pas dy dekadave ka ndryshuar veç kahu idrejtim, ndërsa ishin vullnetarë serbë që arritën në Donbas të Ukrainës për të ndihmuar rusët.

Grushti i dështuar i Malit të Zi i 2016 është shfaqur si një shembull flagrant i ndërhyrjes ruse në Ballkanin Perëndimor. Fillimisht i njohur si “Rusia e Vogël”, një destinacion popullor për shumë turistë rusë dhe një vend i preferuar i oligarkëve të mbështetur nga Moska, Mali i Zi është tani në ballë të kampit anti-rus në Ballkan. Mali i Zi u bë anëtar i NATO-s vetëm gjashtë muaj pas komplotit të dështuar. Kjo pavarësisht pikëpamjes ruse që rusët që e shohin Malin e Zi si vendin e dytë më të preferuar të Ballkanit Perëndimor, përveç serbëve. Perceptuar si një aleat rus, ai u shfaq si vendi më i mirë për investimet e mbështetura nga Moska. Pjesa ruse në GDP e Malit të Zi u rrit përgjatë viteve në mbi 5 për qind, ndërsa mbi 7,000 rusë janë vendosur përgjithmonë në vend. Gjithashtu, rusët kanë fituar kontroll mbi 40 për qind të tregut malazes të pasurive të patundshme, veçanërisht banesat që ndodhen përgjatë bregdetit.

Sot mes vendeve të Ballkanit Perëndimor që mendohet të jenë ende nën rrezën direkte të veprimit të Moskës si sferë influence është Serbia dhe serbët e Bosnje-Herzegovinës (Republika Serbska), ndërsa vendet e tjera janë antare të NATO-s ose vende partnere të perëndimit si Kosova. Por asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është i përjashtuar nga influenza apo shantazhimi rus. Sir Stuart Peach, emisari i lartë i Britanisë së Madhe në Bosnje-Herzegovinë tha në Forumin e “Dialogut të Prespës” në Ohër se “Rusia ka

militarizuar çështjet e energjisë dhe ekonomisë”.<sup>47</sup> Kjo vlen për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, sidomos tani që mungesat e furnizimit me naftë dhe gaz rus janë kthyer në një shqetësim që i prek të gjitha vendet e rajonit.

Ndërkohë sapo filloi agresioni rus mbi Ukrainën, qytetarët në Tiranë dhe gjithë vendin nisën të demonstrojnë në mbështetje të Ukrainës. Media e mbuloi gjerësisht luftën, duke derguar edhe korrespondentë në Kyiv. U zhvilluan shumë debate me këtë temë duke përfshirë edhe rrezikun e disinformacionit rus. Për shembull, Top Channel organizoi një debat në programin Top Story për ndikimin rus në Shqipëri. Aty u tha se në vija të përgjithshme se në Shqipëri, ndikimi ekonomik dhe politik i Rusisë është i vogël pavarësisht përpjekjeve të Kremlinit. Megjithatë, por kjo nuk përjashton ndikimin nëpërmjet korrupsionit, spiunazhit apo medias.<sup>48</sup>

Paradoksi qëndron që ndërsa Rusia është duke ndërhyrë përherë e më tepër në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, ajo akuzon këtë të fundit dhe Kosovën se po dërgojnë mercenarë të luftojnë në krah të Ukrainës. Ministri i Jashtëm Lavrov thotë se: “Ka informacione se mercenarë janë duke u rekrutuar në Kosovë, Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të nxjerrë jashtë ekuilibrit Rusinë dhe për t’i dërguar ato në vende përfshirë Donbass”, tha ai. “Tani po e kontrollojmë dyfish këtë”.<sup>49</sup> Gjithashtu ai shton se: “Kancelari

---

<sup>47</sup> “Escobar: Ballkani duhet të jetë pjesë e BE-së!” *Panorama*, 18 qershor 2022.

<sup>48</sup> Analiza: A rrezikohet Shqipëria nga ekspansioni rus?! 2022. *Top Channel*. 23 Mars. Marrë nga: [Analiza: A rrezikohet Shqipëria nga ekspansioni rus?! - Top Channel \(top-channel.tv\)](#)

<sup>49</sup> “Russia checking reports about mercenaries for Donbass from Kosovo, Albania, B&H — Lavrov”. 2022. *TASS: Russian State Agency*. 22 Shkurt. Marrë nga: [Russia checking reports about mercenaries for Donbass from Kosovo, Albania, B&H — Lavrov - World - TASS](#)



gjerman Olaf Scholz këmbënguli se “NATO ndërhyri për të parandaluar gjenocidin e shqiptarëve të Kosovës dhe ata e bënë atë aq mirë sa rajoni tani po përparon”. Por siç thekson ai me një gjuhë ksenofobiste, “Është larg nga prosperiteti. Kosova dhe disa pjesë të tjera të Ballkanit Perëndimor po bëhen një terren pjellor për krim. Aty ka terroristë dhe shpërndarës droge”. Kjo është në kuadër të fushatës dezinformuese të Moskës ndaj Shqipërisë. Së fundmi Federata Ruse publikoi listën e luftëtarëve të huaj që janë kapur ose eliminuar nga Rusia në konfliktin me Ukrainën ku sipas Kremlinit mercenarët nga Shqipëria ishin 150 vetë dhe 42 prej tyre që janë vrarë.<sup>50</sup> Ndërkohë në të njëjtin raport saktësohet se Kosova e ka këtë numër respektivisht në shifrat 156 dhe 61. Por ish-kryeministri dhe deputeti Pandeli Majko e ka kundërshtuar një gjuhë të tillë aspak diplomatike, duke përmendur hartën e vendeve nga ku kanë ardhur luftëtarë të huaj, duke i'u referuar kësij një kronike të televizionit WION të Indisë.<sup>51</sup> Kjo hartë i hedh poshtë pretendimet ruse për luftëtarë të huaj të përbërë në masë të konsiderueshme nga shqiptarë të Shqipërisë dhe Kosovës.

Ndërkohë, implikimet e luftës në Ukrainë për Ballkanin vazhdojnë të trajtohen në analiza të ndryshme, kryesisht të marra nga shtypi i huaj. Bota.al ripublikoi një analizë të

---

<sup>50</sup> “Ambasada Ruse në Tiranë publikon statistikën e Ministrisë së Mbrojtjes: 150 mercenarë nga Shqipëria luftojnë në Ukrainë”. *Panorama*. 18 Qershor 2022. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/lajm-i-fundit-ambasada-ruse-ne-tirane-publikon-statistikat-e-ministrise-se-mbrojtjes-150-mercenare-nga-shqiperia-luftojne-ne-ukraine/>

<sup>51</sup> “Mercenarë nga Shqipëria dhe Kosova po rekrutohen për luftën në Donbas”, Pandeli Majko reagon pas deklaratës së Lavrov: Ambasada ruse të japë shpjegime”. 2022. *Gazeta Tema*. 22 shkurt. Marrë nga: [“Mercenarë nga Shqipëria dhe Kosova po rekrutohen për luftën në Donbas”, Pandeli Majko reagon pas deklaratës së Lavrov: Ambasada ruse të japë shpjegime - Politika \(gazetatema.net\)](https://www.gazetatema.net/en/mercenarë-nga-shqipëria-dhe-kosova-po-rekrutohen-për-luftën-në-donbas-pandeli-majko-reagon-pas-deklaratës-së-lavrov-ambasada-ruse-të-japë-shpjegime/)

Foreign Policy, ku autorja Jade McGlynn nënvizon se “Duke thirrur Kosovën në Ukrainë, Rusia po i demonstroi vetes se është kthyer në statusin e fuqisë së madhe dhe synon të kryejë zhbërjen e arkitekturës së sigurisë së pas Luftës së Ftohtë, duke tentuar një rend tjetër botëror, në vend që thjesht të rishikojë rregullat aktuale”.<sup>52</sup> Ndërkohë Exit.al botoi një artikull të Sidita Kushit ku thuhej se “Ndërsa Putini bën një luftë të zgjedhur dhe revizionizëm gjeopolitik në Ukrainë, ata që vazhdojnë të barazojnë veprimet e tij me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, vetëm sa po ndezin flakët e një konflikti më të madh. Ata po pranojnë justifikimet e Putinit për agresion dhe po i hapin derën irredentizmit të mëtejshëm në Ballkan”.<sup>53</sup> Tezë kjo e përafërt me argumentimin e Ilir Kalemaj për faqen e analizës të A2 CNN.<sup>54</sup> Ndërkohë zyrtarët rusë këmbëngulin në kufijtë e absurditetit që e drejta e vetvendosjes për rusët e Krimesë dhe të Donbasit është e njëjtë me precedentin e Kosovës ndonëse nuk e njohin këtë të fundit si republikë. Madje kanë bërë cmos ta minojnë procesin e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës. Siç ka argumentuar së fundmi analisti gjerman i Ballkanit, Bodo Weber, “krahasimi që bën Kremlinin mes Kosovës dhe Krimesë, absolutisht nuk qëndron”.<sup>55</sup>

---

<sup>52</sup> Jade McGlynn. 2022. “Pse Putin vazhdon të flasë për Kosovën”? *Bota.al*. 5 mars. [Pse Putin vazhdon të flasë për Kosovën? – bota.al](https://www.bota.al/2022/03/04/pse-putin-vazhdon-te-flase-per-kosoven/)

<sup>53</sup> Sidita Kushi. 2022. “Comment: Don’t Compare Russia’s War to NATO in Kosovo”. *Exit.al* 1 mars. [Comment: Don’t Compare Russia’s War to NATO in Kosovo - Exit - Explaining Albania](https://www.exit.al/2022/03/01/comment-dont-compare-russias-war-to-nato-in-kosovo-exit-explaining-albania/)

<sup>54</sup> Ilir Kalemaj. 2022. “Russia’s irredentism and the existence of Ukraine as a nation-state”. *A2 CNN*. 4 mars. <https://english.a2news.com/2022/03/04/russias-irredentism-and-the-existence-of-ukraine-as-a-nation-state/>

<sup>55</sup> Analisti: Krahasimi rus i Kosovës me Krimesë, absolutisht i paqëndrueshëm. 2022. *Gazeta Tema*. 23 shkurt. [Analisti: Krahasimi rus i Kosovës me Krimesë, absolutisht i paqëndrueshëm - Rajoni \(gazetatema.net\)](https://www.gazetatema.net/2022/02/23/analisti-krahasimi-rus-i-kosoves-me-krimese-absolutisht-i-paqendrueshem/)

Nga ana tjetër, shumë analistë e shohin ngushtësisht të lidhur përshejtimin e integritit të Ballkanit Perëndimor si parakusht për përparimin e proceseve të integritit për Ukrainën apo Moldavinë. Për shembull, Exit publikoi një koment mbi implikimet e anëtarësimit të Ukrainës në BE për Ballkanin Perëndimor ku theksohet *inter alia* se “nëse BE-ja dështon objektivin e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, do të jetë shumë e vështirë të bindet dikush që BE-ja është serioze për perspektivën e anëtarësimit të Ukrainës”.<sup>56</sup> Këtë bindje e ndan edhe eksperti i BE-së Gledis Gjipali në një shkrim për Institutin Shqiptar të Medias.<sup>57</sup>

Në vija të përgjithshme mund të themi që tensionet mes Moskës dhe Tiranës janë rritur pas agresionit rus ndaj Ukrainës kur Shqipëria është një ndër vendet që është solidarizuar hapur me këtë të fundit. Kjo si rezultat edhe i përgjegjësisë si bashkë-penë mbajtëse në Këshillin e Sigurimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës siç është shprehur kryeministri Rama.<sup>58</sup> Rreziku rus supozohet se do të sjellë përshejtimin e integritit të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi dhe Shqipërinë në veçanti, siç është shprehur ndër të tjerë publicisti dhe diplomati Shaban Murati.<sup>59</sup> Por kjo

---

<sup>56</sup> Alice Taylor. 2022. What Ukraine’s EU Membership Bid Means for the Western Balkans. *Exit.al*. 19 mars. [What Ukraine’s EU Membership Bid Means for the Western Balkans - Exit - Explaining Albania](#)

<sup>57</sup> Gledis Gjipali. 2022. “Lufta në Ukrainë dhe ndikimi në antarësimin e Ballkanit në BE”. *Transition Promotion Program*. Institutit Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

<sup>58</sup> Juliana Prifti. 2022. “Rama: Shqipëria dhe SHBA, bashkëpenëmbajtëse të çështjes së Ukrainës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së”. 5 shkurt. *Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATA)*. Marrë nga: <https://ata.gov.al/2022/02/05/rama-shqiperia-dhe-shba-bashkepenembajtese-te-ceshtjes-se-ukraines-ne-keshillin-e-sigurimit-te-okb-se/>

<sup>59</sup> “Shaban Murati: A ka mundësi që rreziku i një kërcënimi rus të përshejtojë proceset integruese në BE të Ballkanit?” 2022. *Albspirit*. Marrë nga: <https://alb-spirit.com/2022/02/26/shaban-murati-ka-mundesi-qe-rreziku-nje-kercenimi-rus-te-pershejtoje-proceset-integruese-ne-te-ballkanit/>

është njëra anë e medaljes se në shkrime të tjera publicisti Murati ka qenë veçanërisht i ashpër me politikën e jashtme të Shqipërisë karshi Rusisë. Madje ai ka duke arritur deri aty sa ta akuzojë atë për dhënien e mundësisë Rusisë që të penetrojë në rajon, duke i dhënë në raste të caktuara “çelësin” e aksesit në lagjen tonë ballkanike.<sup>60</sup>

Në përgjithësi, sikundër kanë vërejtur me të drejtë studiues të ndryshëm, ndikimi rus në rajon ka ardhur në proporcion të drejtë me cënimin e stabilitetit dhe paqes së brishtë. Siç thekson së fundmi Andi Hoxhaj: “Nëse BE-ja nuk e merr aq seriozisht sa duhet ndikimin në rritje të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, rrezikon të krijojë armiq në kufijtë e saj. Dhe në kulmin e luftës Ukrainë-Rusi, kjo do të ishte vërtet shumë e rëndë”.<sup>61</sup>Gjithsesi, pavarësisht ndërhyjes në rritje ruse në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria është relativisht më e mbrojtura nga vendet e Ballkanit Perëndimor nga influenza ruse. Madje edhe më tepër sesa Kosova e cila është e ndjeshme në pjesën e veriut të Mitrovicës ku lëvizjet separatiste të serbëve atje shpesh financohen ose ndihmohen direkt nga Kremli. Edhe përsa i përket ndikimit mediatik, nuk evidentohet ndonjë rast i ndonjë media lokale në Shqipëri të financuar drejtëpërdrejtë nga Kremli, pavarësisht spekulimeve. Natyrisht që ekziston rreziku i dezinformimit nëpërmjet organeve propagandistike ruse si Russia Today, Sputnik News apo satelitëve të tyre rajonalë. Por Shqipëria e ka ancoruar qartazi spirancën e politikës së jashtme kah Perëndimit dhe si vend antar i NATO-s i ka pasur të qarta pozicionet e saj ndaj Moskës.

---

<sup>60</sup> Shaban Murati. 2022. “Rreziku rus në portat e Ballkanit: Një çelës e ka dhënë Tirana”. *Gazeta Dita*.

<sup>61</sup> Andi Hoxhaj. 2022. “Ndikimi i Rusisë në Ballkan po rritet pikërisht kur po cenohet paqja e brishtë e rajonit”. *CNA*. 19 korrik. <https://www.cna.al/opinione/ndikimi-i-rusise-ne-ballkan-po-rritet-pikerisht-kur-po-cenohet-paqja-e-i320371>

## **b. Kina**

Ndikimi i Kinës në Ballkanin Perëndimor po merr formën e një “fuqie të mprehtë” (smart power) për shkak të kombinimit të influencës politike dhe ndikimit ekonomik që përdor. Kina është një fuqi tashmë e konsoliduar me aspirata globale e cila është duke kërkuar të korrigjojë qasjen shpeshherë unilaterale të Shteteve të Bashkuara duke provokuar atë që shumë vëzhgues gjeopolitikë po e quajnë një “luftë të re të ftohtë” (Gladstone 2020).

Përsa i përket interesit specifik të Kinës për vendet e Ballkanit Perëndimor, mund të themi që vitet e fundit, investimet infrastrukturore apo në sektorë si energjia, transporti dhe nafta kanë ardhur duke u shumëfishuar, duke iu përshtatur njëkohësisht dhe natyrës së ndryshme që kanë ekonomitë e secilit vend. Ndër të dhënat që na vijnë nga rajoni, për shembull për Maqedoninë e Veriut, niveli i investimeve kineze dhe kontratat e siguruara me këtë vend ka shkuar mbi 400 milion dollarë përgjatë viteve 2005-2018, por me një kreshendo të mëtejshme sidomos në vitet e fundit. Për Kinën, Maqedonia Veriore është një lidhje midis investimeve të saj me portin e Pireut në Greqi ku investimet kineze kanë shkuar rreth rreth 10 miliardë euro dhe Serbisë, ku Kina deri më tani ka shpenzuar afërsisht të njëjtën shumë, 10.2 miliardë euro (Seaman et al. 2017).

Shumica e këtyre vendeve të vogla të Ballkanit janë mjaft të ndjeshëm ndaj investimeve kineze, vençarisht pas krizës financiare globale që nisi në 2008-ën dhe vazhdoi për disa vjet dhe këtu mund të veçojmë rastin e Greqisë të nënvizuar edhe më sipër. Ndërkohë që krizat e mëpasshme, kanë bërë që gjithnjë e më tepër sytë të kthehen nga Kina për të përfituar veçanërisht financime apo hua të pakondicionuara apo të bashkë-shoqëruara më kushte politike.

Në fakt disa vende kërkojnë financim investimesh dhe për projekte jo fort rentabël nga pikëpamja ekonomike si për

shembull Mali i Zi. Prioriteti i Serbisë në planet e Kinës për Ballkanin Perëndimor përmban gjithashtu ndikim politik, përveç influencës ekonomike. Qysh nga koha kur ambasada kineze u vu në shënjestër gabimisht nga bombardimet ajrore të NATO-s në 1999 që ishin kundërpërgjigje ndaj fushatës së spastrimit etnik të Milosheviqit në Kosovë, marrëdhëniet Kinë-Serbi kanë qenë të ngushta, me Kinën vazhdimisht duke mbështetur pozicionin e Serbisë ndaj Kosovës si dhe duke mos pranuar formulë tjetër përpos asaj që do të dakordësohej mes dy vendeve në një marrëveshje formale mes tyre, një pozicionim ky me mjaft rëndësi për Serbinë, duke marrë parasysh edhe faktin që Kina është anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me të drejtë vetoje në çështje të tilla.

Kina synon të avancojë interesat e saj gjeo-strategjike me vendet e Ballkanit Perëndimor ku përfshihet edhe Shqipëria, përmes marrëveshjeve tregtare dhe faktit që është ndër vendet eksportues kryesorë si dhe investitor kyç përmes kompanive gjysëm-shtetërore dhe private, si dhe një diplomacie të sukseshme ekonomike. Megjithatë për ta përmbledhur, mund të citojmë njohësin dhe studiuesin e njohur Jens Bastian kur shprehet se mbetet e paqartë, nëse dhe çfarë agjende politike fshihet pas investimeve kineze. “Kina nuk ka interes, ndryshe nga Rusia, që të nxisë një ndryshim qeverish në këto vende”, thotë ai. Sipas interpretimit që ai bën “interesi kinez gjeostrategjik aktual ka vetëm natyrë ekonomike, si një pjesë tranziti për tregjet e pasura perëndimore. E fakti që Kina askujt në këto vende nuk i mban leksione për të drejtat e njeriut apo lirinë e medias më shumë mirëpritet nga qeveritë e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor”<sup>62</sup>

---

<sup>62</sup> Zoran Arbutina. 2018. “Kina hyn në Ballkan - po a përbën rrezik?” 27 shtator. Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/kina-hyn-n%C3%AB-ballkan-po-a-p%C3%ABrb%C3%ABn-rrezik/a-45647868>

Gjithashtu Kina po përdor gjithnjë e më shpesh forma të diplomacisë kulturore të tilla si Instituti Konfucius, qendrat kineze të kulturës, aktivitetet e trashëgimisë kulturore, bursat për studentë, turizmi dypalësh etj. Në rastin e Shqipërisë, Kina përmes përfaqësuesve të saj zyrtarë dhe jo vetëm, i referohet shpesh së kaluarës historike, marrëdhënies së ngushtë që kanë pasur dy vendet përgjatë viteve '70 të shekullit të kaluar, investimeve kineze në energjetikë dhe industrinë e rëndë apo eksporteve kulturore të Shqipërisë komuniste si filmat, por njëkohësisht insiston në faktin që Kina bashkëpunon me sisteme të ndryshme politike dhe nuk ndërhyr në punët e brendshme të vendeve të caktuara. Kjo narrativë dhe këto ide janë përdorur *en bloc* për të avancuar tezën e thellimit të bashkëpunimit ndër-shtetëror mes Shqipërisë dhe Kinës.

Gradualisht, Kina ka rritur influencën mediatike në Shqipëri. Shembujt të kësaj janë Radio Kina Internacional e cila është aktive prej kohësh në Shqipëri. Gjithashtu Kina mbështet Radio-Ejani që promovon politikën e saj. Gjithashtu, Kina ka rritur prezencën në televizionin publik. Sipas [China.org.cn](http://China.org.cn), RTSH ka nënshkruar një marrëveshje me Kinën për transmetimin e programeve kineze në vitin 2019, konkretisht emisionin e quajtur “Fëmijët e qytetit Wuzhumuqin”.<sup>63</sup> Ndërkohë ka edhe emisione specifike, si për shembull emisioni “Shqipëria ecën në rrugën e mëndafshit” në RTSH. Vetë RTSH e përshkruan si më poshtë: “një dokumentar televiziv që pasqyron zhvillimin e vrullshëm të bashkëpunimit ekonomik mes Kinës dhe vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, përfshirë Shqipërinë”. Kjo mund të quhet me lehtësi si propagandë kineze. Por në përgjithësi, nëse shikojmë orarin e përgjithshëm të RTSH-së, ka mungesë

---

<sup>63</sup> “Albania, China sign agreement on broadcasting of TV programs”. 20 Tetor. Marrë nga: [Albania, China sign agreement on broadcasting of TV programs - China.org.cn](http://Albania, China sign agreement on broadcasting of TV programs - China.org.cn)

të emisioneve, filmave dhe programeve kineze, po të kemi parasysh se po aq vëmendje apo edhe më shumë vëmendje i kushtohet Rusisë apo Indisë në të njëjtin hark kohor.

Nga ana tjetër, sipas një raporti të publikuar nga Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (Shopov, 2021) ka marrëveshje të ndryshme mes Kinës me homologët e Ballkanit Perëndimor për të mos marrë mbulim negativ në mediat e tyre përkatëse. Këto media shpesh duket se shmangin referenca ndaj informacionit rreth kushteve të diskutueshme që i bashkëngjiten projekteve kineze. Imperativi i zhvillimit ekonomik në vendet me liri të kufizuar të medias u lejon qeverive në rajon të kontrollojnë rrjedhën e përmbajtjes në Kinë dhe marrëdhëniet dypalëshe me vendin. Nga një artikull i publikuar në *reporter.al* nga Nensi Bogdani, përmendet se një raport i bërë nga fondacioni Konrad Adenauer thotë se në Shqipëri nuk ka politika mediatike editoriale të identifikuar, as pro-kineze, as media me pronësi kineze. Në të njëjtin artikull përmendet se Kina po ofron një numër të konsiderueshëm produktesh falas, të tilla si dokumentarë mbi sistemin e qeverisjes në Kinësi “Kina: Koha Xi”.<sup>64</sup>

### **c. Vendet Arabe**

Vendet e Gjirit Persik dhe në veçanti Arabia Saudite, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë mbi një dekadë që kanë shtrirë influencën e tyre kryesisht ekonomike, por edhe politike dhe kulturore në vende të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Serbi, Bosnje-Herzegovinë dhe Mal të Zi. Kuptohet që influenca

---

<sup>64</sup> Nensi Bogdani. 2021. “Kina rrit ndikimin mbi mediat publike shqiptare, vëren raporti”. *Reporter*. 7 janar. <https://www.reporter.al/2021/01/07/kina-rrit-ndikimin-mbi-mediat-publike-shqiptare-veren-raporti/>



e tyre është mjaft e kufizuar dhe vetëm në shtete si Bosnje-Herzegovina apo në rajone të veçanta si Sanxhaku në Serbi. Ndërsa kur vjen puna te investimet ekonomike, Serbia dhe Mali i Zi kanë përfituar më së shumti. Për shembull, Emiratet e Bashkuara Arabe kanë investime direkte në Serbi mbi 3 përqind të totalit, duke u renditur pas Bashkimit Evropian, Rusisë dhe Kinës dhe përfshijnë investime strategjike si ai i “Belgrade Waterfront”, një investim 3 miliardë dollarësh.<sup>65</sup> Gjithashtu Katari ka investuar në sektorin bujqësor në Serbi, ndërsa Emiratet e Bashkuara Arabe janë ndër vendet e Gjirit me më shumë investime të huaja direkte në Mal të Zi. Ndërkohë qytetarë të pasur nga Arabia Saudite kanë blerë prona dhe imobiliare të ndryshme në Bosnje-Herzegovinë.

Ndërkohë në Shqipëri, investimet nga Emiratet e Bashkuara Arabe kanë arritur në 40 milionë euro vetëm për vitin 2020.<sup>66</sup> Gjithashtu pritet një mega-investim prej 2 miliardë dollarësh për rivitalizimin e portit të Durrësit po nga ky vend. Megjithatë kjo është pritur me skepticizëm nga një pjesë e mediave shqiptare.<sup>67</sup> Nga ana tjetër, Fondi i Abu-Dhabit ka premtuar njëkohësisht financimin e projektit të Bulevardit të Ri dhe Lumit të Tiranës që kanë kohë që kanë nisur nga puna.<sup>68</sup> Në përgjithësi ka pak transparencë për investimet

---

<sup>65</sup> Vuk Vuksanovic. 2021. “Serbia’s best friend in the Arab World: the UAE”. 9 korrik. Marrë nga: <https://www.mei.edu/publications/serbias-best-friend-arab-world-uae>

<sup>66</sup> Arlinda Gjonaj. 2020. Investimet nga Emiratet e Bashkuara Arabe, 40 milionë euro gjatë vitit 2020. ATA (Agjencia Telegrafike Shqiptare), 3 dhjetor. Marrë nga: <http://ata.gov.al/2020/12/03/investimet-nga-emiratet-e-bashkuara-arabe-40-milione-euro-gjate-vitit-2020/>

<sup>67</sup> Shih për shembull, “Ja çfarë fshihet pas investimit 2 miliard euro në Portin e Durrësit”. 2021. Gazeta Telegraf. 21 qershor. Marrë nga: <https://telegraf.al/ekonomi/ja-çfare-fshihet-pas-investimit-2-miliard-euro-ne-portin-e-durresit/>

<sup>68</sup> A duhet t’u druhemi investimeve arabe në Ballkan? *Gazeta Si*. 1 gusht. Marrë nga: <https://gazetasi.al/a-duhet-ti-druhemi-investimeve-arabe-ne-ballkan/>

nga vendet arabe në Shqipëri, çka shton skepticizmin dhe kritikën në lidhje me këto fonde dhe financime.

Ndonëse ndikimi politik dhe ai kulturor i vendeve arabe ngelen ende të papërfillshme në rajon, penetrimi ekonomik por edhe religjioz përmes rrymave radikale si vahabiste dhe tekfariste ngelet një kërcënim jo i paneglizhueshëm. Për shembull, Deutsche Welle, ndërsa citon ekspertin Vedran Džihić, ka raportuar se rreth 150 dhe 120 xhihadistë janë kthyer përkatësisht në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovë më 30 maj 2017. Mendohet se deri në disa mijëra shtetas të Ballkanit Perëndimor i janë bashkuar Shtetit Islamik në kulmin e aktivitetit të tij terrorist.<sup>69</sup>

Fenomeni është, pa dyshim, pjesërisht rezultat i faktit se një formë strikte e Islamit, vehabizmi, është infiltruar në rajon – në veçanti, në ndikimin e Arabisë Saudite. Sipas Institutit Clingendael, 200 kosovarë morën bursa për të studiuar vahabizmin në Arabinë Saudite.<sup>70</sup> Një artikull i botuar nga Balkan Insight më 29 mars 2010, duke cituar Sunday Times, raportoi se qindra milionë paund sterlina ishin injektuar, kryesisht nga Arabia Saudite, në grupe radikale islamike në Ballkan.<sup>71</sup> Komisioni Evropian në veçanti duhet të ketë një plan të qartë se si po planifikon të mbrojë qytetarët ekzistues

---

<sup>69</sup> "Could Balkan nations become the new hotbeds of Islamist extremism?" *Deutsche Welle*. Marrë nga: <https://www.dw.com/en/could-balkan-nations-become-the-new-hotbeds-of-islamist-extremism/a-39045256>

<sup>70</sup> Danijel Tadic. 2017. "Lack of good governance contributes to growth of radical Islam in the Western Balkans". *Clingendael Spectator* 4, Vol. 71. Marrë nga: <https://spectator.clingendael.org/pub/2017/4/the-growth-of-radical-islam/>

<sup>71</sup> Sinisa Jakov Marukic. 2010. "Report: Saudis Fund Radical Islam In Balkans". *Balkan Insight*, 29 Mars. Marrë nga: <https://balkaninsight.com/2010/03/29/report-saudis-fund-radical-islam-in-balkans/>

të shteteve anëtare nga rreziqet që paraqet Islami radikal që depërton në këto vende si dhe integrimin e atij numri sado të vogël të ish-xhihadistëve të riatdhesuar dhe familjeve të tyre që janë kthyer ndërkohë. Këto janë plagë ende të pambyllura plotësisht dhe kufizimi i ndikimit të vendeve të treta që sponsorizojnë direkt apo indirekt forma të ekstremizmit islam që nuk kanë traditë në rajon, janë kërcënime që duhen adresuar me largpamësi.

## **VI. Fazat e ndryshme të integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE**

Bashkimi European ka një interes të vazhdueshëm të përshpejtojë procesin e integrimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, fillimisht i premtuar zyrtarisht në Samitin e Selanikut në 2003shin dhe e rikonfirmuar para disa vitesh edhe nga Procesi i Berlinit. Në këtë moment, me ndikimin e krizës së paprecedentë të agresionit ushtarak rus ndaj Ukrainës, mendohet se krahas vendimmarrjeve bazuar në meritën e vendeve candidate, nuk përjashtohen edhe faktorët dhe konsideratat gjeopolitike.

Nga ana tjetër, Tirana zyrtare ka kohë që dëgjon parreshtur refrenin e vjetër të “bërjes së detyrave të shtëpisë” përpara hapjes së negociatave për anëtarësim në BE. Parimi i Regattës, ku secili vend do të vlerësohet sipas meritës është një parim i përsëritur qysh nga Samiti i Selanikut në 2003 që çeli rrugën e perspektivës europiane për këto vende. Kjo farë tango ku ne ballkanasit bëjmë sikur i bëjmë detyrat me përpikëri, ata (Brukseli) bëjnë sikur na besojnë dhe në fund ripërsëritet avazi i vjetër i kushteve të stërpërsëritura, janë një sagë që vazhdon. Vendet europiane mund të kenë rezerva specifike, por bashkohen tek reforma e gjyqësorit dhe mirëfunksionimi i shtetit të së drejtës.

Thënë kjo, nuk mund të përjashtohet apriori që vende specifike mund të kenë kërkesa specifike, ndonëse mund

mos të arrijnë deri aty sa të jenë bllokuese. Për shembull, Greqia mund në një të ardhme të vendosë të vështirësojë antarësimin e Shqipërisë në BE nëse nuk merr sipas tyre zgjidhje përfundimtare çështja e mbrojtjes së pronave të minoritarëve grekë në Shqipëri apo zgjidhja përfundimtare e delimitimit të shelfit kontinental. Zgjidhja e çështjes së detit, një problem i mprehtë dhe aktual, nuk është dhe nuk duhet të jetë një emergjence për të përfituar mbështetjen e Greqisë, por një zgjidhje ligjore dhe profesionale që do t'i rezistojë kohës dhe nuk do të ushqejë nacionalizmin apo qëndrime bllokuese. Referimi te Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është një hap në drejtimin e duhur, por nese nuk shoqerohet me përgatitje serioze nga pala shqiptare mund të ishte dhe një bumerang dhe një kosto e lartë integrimi për Shqipërinë. Rasti i Kroacisë është tregues i mirë se çfarë mund të ndodhë me hapjen e negociatave. Kroacia i hapi në 2005 negociatat me kusht për bashkëpunim të plotë me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë. Nga prilli deri në tetor u vëzhgua më imtësi procesi i bashkëpunimit nga ana e Kroacisë deri sa Këshilli e pranoi arsyetimin e Komisionit për bashkëpunim të plotë dhe pa kushte të Kroacisë si dhe rishikimin tërësor të legjislacionit të vendit që u gjykua të ishte në përputhje me *acqui communitaire*. Ndërkohë problemet e Kroacisë me Slloveninë për Gjirin e Piranit dhe të drejtat e peshkimit vazhdojnë edhe sot e kësaj dite me Kroacinë që refuzon një arbitrim ndërkombëtar, ndonëse të dyja vendet janë pjesë e së njëjtës familje të BE-së.

Nga ana tjetër, ndërsa Kroacia e mori statusin kandidat në 2004 dhe u bë pjesë e BE-së në 2013, Maqedonia që e mori veç një vit më pas statusin kandidat, pra në 2005, arriti t'i hape negociatat vetem se fundmi.

Krejt ndryshe situata me Malin e Zi që brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër si shtet i mëvetshëm ka arritur

progres të qenësishëm që nga marrja e statusit kandidat në 2010, hapjen e negociatave në 2012 dhe hapjen e 30 kapitujve të negociatave duke përfunduar suksesshëm tre prej tyre. Serbia, me dy vjet vonesë në secilin prej këtyre hapave të Malit të Zi, është në radhë për të qenë e dyta nga vendet që priten të anëtarësohen sipas projeksioneve të fundit të zyrtarëve të BE-së dhe analistëve politikë, ndonëse në rastin serb vlen të rikujtojmë dhe kushtëzimin me njohjen e Kosovës në një moment të dytë.

Konflikti i fundit i nxitur nga Moska, është një prej sinjaleve të radhës që procesi i integrimit duhet përsheptuar. Shqipëria dhe Ballkani nuk duhet te prese pa fund si barbarët në Romën e lashtë *ante portas*. Situata në kontinentin tonë duhet të shërbejë si një moment reflektimi kombëtar për prioritetet dhe sfidat e vendit, për të mos e humbur trenin e integrimit edhe kësaj here. Është detyrë e mazhorancës që të shtrijë dorën e bashkëpunimit të sigurtë institucional me aktorët dhe faktorët opozitarë për të krijuar kushtet për një dialog kombëtar përtej retorikës politike të ditës në lidhje me çështjet e integrimit. Opozita, gjithashtu, duhet ta shohë si një mundësi kapitalizimi politik bashkëpunimin për një proces integruar më pak konfliktual dhe të orientuar drejt debatit teknik për realizimin e atyre kushteve dhe kriterëve që çelja e negociatave dhe mandej negocimi i suksesshëm i tyre të mos hasë në mure bllokuese. Nëse integrimi vërtetë do të kërkohet si mundësi e përmirësimit të jetës së shqiptarëve, llogaritë duhet të jenë të ftohta dhe të shmangët përdorimi si instrument politik për ta shitur si produkt elektoral në favor të njërës apo tjetrës palë.

## VII. Përfundime

Ky studim u mundua të hidhte dritë mbi perceptimin e përpjekjeve të Shqipërisë për t'u antarësuar në BE, raportin ku qëndron Shqipëria në raport me fqinjët, si dhe sfidat e brendshme dhe të jashtme që ballafaqohen vendet e Ballkanit Perëndimor në raport me BE-në. Vetëm duke pasur këtë panoramë të përgjithshme të ndarë në seksione të ndryshme përgjatë punimit, mundemi të kontekstualizojmë veçantitë e rastit shqiptar por edhe të kuptojmë në mënyrë kritike sjelljen e elitës politike dhe atyre të medias dhe shoqërisë civile në raport me Brukselin. Punimi sjell edhe evidencat përkatëse për përfshirjen e aktorëve të tretë në Ballkanin Perëndimor dhe sesi këto vende kanë ndikuar në rrugëtimin e integritetit të secilit vend për në BE, por edhe sjelljen e elitave përkatëse të këtyre vendeve në raport me Brukselin.

Mënyra sesi Bashkimi Evropian, problematikat që lidhen jo vetëm me procesin e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor, por edhe se si vetë BE paraqitet në media dhe forume publike ka të bëjë dhe me vetë lirinë dhe integritetin e medias. Media nuk është ose së paku nuk duhet të jetë vetëm përcjellëse neutrale e informacionit, por edhe sendërtuese e opinionit publik dhe një pushtet i katërt realisht me peshë në ndikimin e politikave publike. Fakti që liria e medias në Shqipëri ka bërë hapa mbrapa nuk e bëjnë median as më të besueshme për opinionin publik, as mjaftueshëm influencuese për politikën

dhe pushtetin. Natyrshëm që parë në këtë prizëm edhe roli i medias në influencimin e perceptimit publik për BE-në ngelet i reduktuar. Fakti që mungon dhe ekspertiza e mjaftueshme në mediat shqiptare në lidhje me zhvillimet në BE apo procesin e zgjerimit e bën akoma më problematik këtë fakt.

Natyrisht punimi ka limitet e veta dhe më tepër se një studim shterrues për çështjen në fjalë, synon të hapë një debat në lidhje me sfidat e sipërcituara dhe sesi të mund të kontekstualizojmë rastin e Shqipërisë në situatën aktuale. Gjithashtu synon të provokojë pyetje të tilla të nxehta si: a kemi rritje të euroskepticizmit ndër elitat drejtuese në rastin e Shqipërisë? Nëse po, a është ky strukturor dhe sistemik, apo thjesht sjellje reaguese ose provokuese ndaj dyerve të mbyllura të BE-së? Gjithashtu studimi sheh reagimin publik ndaj planeve alternative si ajo e Komunitetit Politik Evropian të propozuar së fundmi nga Presidenti Macron apo ideja që i parapriu këtij propozimi të fundit si ajo e “Evropës së dy shpejtësive”, ku në thelb është ideja e një paradhome të përhershme për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Nga ana tjetër shtrohen gjithashtu pyetje me valencë në debatin publik dhe politik, të tilla si: në ligjërimin publik a duhet të ketë Shqipëria një plan B apo është e destinuar të ketë vetëm integrimin e plotë në BE si të vetmin finalité politique? Cilat janë leksionet që na vijnë nga fqinjët ballkanikë, qoftë ata që janë integruar plotësisht, si Rumania, Bullgaria ose Kroacia, qoftë ata që momentalisht janë përpara nesh në këtë rrugëtim si Mali i Zi dhe Serbia? Dhe së fundmi, a janë vendet e treta, veçanërisht ndikimi gjeopolitik rus dhe penetrimi gjeoekonomik kinez kërcënime me aftësinë për të ndryshuar kurs të këtyre vendeve apo thjesht nxisin një marrëdhënie akoma më të afërt mes Brukselit dhe kryeqyteteve ballkanike? Këto pyetje janë duke u shtruar në mediat e Tiranës dhe janë duke u diskutuar dhe debatuar nga politikanë dhe shtetarë, gazetarë, analistë dhe studiues, duke sendërtuar një ligjërim publik të



caktuar, ndërsa synojnë të influencojnë pikëpamjet e publikut të gjerë. Disa nga gjetjet e sjella në këtë punim, ndihmojnë së paku pjesërisht në përgjigjet e këtyre pyetjeve, ndërsa evidenca shtesë dhe përfundime edhe më shterruese mund të sillen nga autorë që i trajtojnë në mënyrë të diferencuar secilën prej këtyre temave dhe nën-temave në trajtë akademike apo rekomandimesh që lidhen me politikë-bërjen.

Zvarritja e procesit të integritimit dhe ngecja e nisjes negociatave deri tani, kanë impaktuar çdo qelizë të jetës politike, ekonomike, sociale dhe ndërkombëtare të Shqipërisë. Shqiptarët nuk kanë pritur pasivisht hapjen e negociatave dhe aq më pak antarësimin e plotë në BE por përmes valëve migratore janë munduar t'i bashkangjiten vendeve të Unionit sa më shpejt. Kjo ka krijuar dhe flukse emigrantësh të paligjshëm dhe kërkesash për azil që janë kthyer në një shqetësim për vende të caktuara të BE-së.

Pra në njëfarë mënyre shqiptarët e kanë marrë vetë në dorë integritimin duke e kërkuar në vendet e BE-së atë që BE-ja ka premtuar dhe premtton se do e krijojë në Shqipëri pikërisht përmes procesit të integritimit dhe përafrimit me BE-në. Ngelet për t'u parë nëse hapja e negociatave do të përmisojë ndjeshëm implementimin e legjislacionit, konsolidojë shtetin e së drejtës, frenojë korrupsionin dhe rritur standartin e mirëqënies, duke bërë që shqiptarët ta gjejnë Europën në Shqipëri. Kjo natyrisht kërkon para së gjithash vullnet politik nga ana e qeverisë, si dhe europeanizim të shoqërisë me ndikim të ndërsjelltë mes BE-së dhe Shqipërisë që arrihet përmes ndërveprimit dinamik. Kjo do të ndikonte në politikën e brendshme, politikat publike dhe shoqërinë në tërësi dhe për këtë arsye është e rëndësishme për qytetarët dhe bizneset. Paralelisht dhe si vlerë të shtuar do të sillte dhe një perceptim konstant pozitiv për BE-në në Shqipëri dhe një ligjërim publik që e mbështet këtë perceptim.

## VIII. Referencat

A duhet t'u druhemi investimeve arabe në Ballkan? Gazeta Si. 1 gusht. Marrë nga: <https://gazetasi.al/a-duhet-ti-druhemi-investimeve-arabe-ne-ballkan/>

Albanian Public Perception of the EU. The delegation of the European Union to the Republic of Albania. [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/albanian\\_public\\_perception\\_of\\_the\\_eu\\_2019\\_0.pdf?fbclid=IwAR1XqXUvyhGy8jLHuzmb3CiKavrbsly0fcHlrH3aS\\_Bg3eKoM7940miE5o](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/albanian_public_perception_of_the_eu_2019_0.pdf?fbclid=IwAR1XqXUvyhGy8jLHuzmb3CiKavrbsly0fcHlrH3aS_Bg3eKoM7940miE5o)

"Albania starts Covid-19 vaccinations as PM blasts slow EU help". AFP. 11.01.2021. Marrë nga: [Albania starts Covid-19 vaccinations as PM blasts slow EU help - France 24](#)

"Albania, China sign agreement on broadcasting of TV programs". 20 Tetor. Marrë nga: [Albania, China sign agreement on broadcasting of TV programs - China.org.cn](#)

"Ambasada Ruse në Tiranë publikon statistikat e Ministrisë së Mbrojtjes: 150 mercenarë nga Shqipëria luftojnë në Ukrainë". *Panorama*. 18 Qershor 2022. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/lajm-i-fundit-ambasada-ruse-ne-tirane-publikon-statistikat-e-ministrise-se-mbrojtjes-150-mercenare-nga-shqiperia-luftojne-ne-ukraine/>

“ANALIZA: E vërteta e planit “pa ndjenja” të Macronit mbi zgjerimin BE-së”. *Gazeta Tema*. 27 Maj 2022. Marrë nga: <https://www.gazetatema.net/bota/analiza-e-verteta-e-planit-pa-ndjenja-te-macronit-mbi-zgjerimin-e-be-se-i340336>

Analiza: A rrezikohet Shqipëria nga ekspansioni rus?! 2022. *Top Channel*. 23 Mars. Marrë nga: [Analiza: A rrezikohet Shqipëria nga ekspansioni rus?! - Top Channel \(top-channel.tv\)](https://www.topchannel.tv/analiza-a-rrezikohet-shqipëria-nga-ekspansioni-rus-2022)

Analisti: Krahasimi rus i Kosovës me Krimenë, absolutisht i paqëndrueshëm. 2022. *Gazeta Tema*. 23 shkurt. [Analisti: Krahasimi rus i Kosovës me Krimenë, absolutisht i paqëndrueshëm - Rajoni \(gazetatema.net\)](https://www.gazetatema.net/analisti-krahasimi-rus-i-kosovës-me-krimenë-absolute)

Arbutina, Zoran. (2018). “Kina hyn në Ballkan - po a përbën rrezik?” 27 Shtator. Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/kina-hyn-në-ballkan-po-a-përbën-rrezik/a-45647868>

Barko, Noah & Alexandar Vasović. 2018. Chinese ‘highway to nowhere’ haunts Montenegro. Reuters. See for more: <https://www.reuters.com/article/us-china-silkroad-europe-montenegro-insi/chinese-highway-to-nowhere-haunts-montenegro-idUSKBN1K60QX>

Bastian, Jens. 2020. “China’s Evolving Footprint in the Western Balkans: Navigating between the Belt and Road Initiative and the Covid-19 Pandemic.” *Tirana Observatory: Foreign Policy & International Relations*. Vol.2, No. 3. Tiranë: Albanian Institute of International Studies.

Bastian, Jens. 2017. “The potential for growth through Chinese infrastructure investments in Central and South-Eastern Europe along the “Balkan Silk Road”. *Report prepared for European Bank for Reconstruction and Development*.

Baze, Mero. 2022. “Çelja e negociatave, ua heq Shqipërinë nga duart politikanëve shqiptarë”. *Gazeta Tema*. 19 korrik. <https://www.gazetatema.net/editorial/elja-e-negociatave-ua-heq-shqiperine-nga-duart-politikaneve-shqiptare-i347711>

Baze, Mero. 2022. “Rreziqet nga hezitimi evropian për Ballkanin”. *Gazeta Tema*. 23 Qershor. Marrë nga: <https://www.gazetatema.net/editorial/rreziqet-nga-hezitimi-evropian-per-ballkanin-i344180>

Bogdani, Nensi. 2021. “Kina rrit ndikimin mbi mediat publike shqiptare, vëren raporti”. *Reporter*. 7 janar. <https://www.reporter.al/2021/01/07/kina-rrit-ndikimin-mbi-mediat-publike-shqiptare-veren-raporti/>

“Bullgaria heq veton, por BE nuk jep vendim/ Macron: Hap para, por jo fitore”. 2022. *Top Channel*. Marrë nga: <https://top-channel.tv/2022/06/24/bullgaria-heq-veton-por-be-nuk-jep-vendim-macron-hap-para-por-jo-fitore43/> 24 qershor.

Bushati, Ditmir. 2022. “Zgjimi Evropian”. Riprodhuar nga gazeta *Panorama*. 6 qershor. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/zgjimi-evropian/>

Cipa, Akri. 2021. “The EU should resist moves to halt Balkan enlargement.” May 18. *Euraktiv*. Marrë nga: [The EU should resist moves to halt Balkan enlargement – EURACTIV.com](https://www.euractiv.com/en/balkan-enlargement/the-eu-should-resist-moves-to-halt-balkan-enlargement/)

“Covid: first vaccinations in Albania, Rama criticizes EU.” ANSAMed 11 Janar 2021. Marrë nga: [Covid: first vaccinations in Albania, Rama criticizes EU - Politics - ANSAMed.it](https://www.ansamed.it/en/news/11-jan-2021-covid-first-vaccinations-in-albania-rama-criticizes-eu-politics/)

Dervishi, Lutfi. 2022. “Hapja e negociatave, maratona e radhës drejt BE”. *Panorama*. 19 korrik. <http://www.panorama.com.al/hapja-e-negociatave-maratona-e-radhes-drejt-be/>

“Edi Rama nuk përmbahet para Samitit të BE: Turp për Evropën, që është kaq impotente para Bullgarisë”. 2022. *Gazeta Tema*. 23 Qershor. Marrë nga: <https://www.gazetatema.net/politika/edi-rama-nuk-permbahet-para-samitit-te-be-turp-per-evropen-qe-eshte-kaq-i344062>

“Escobar: Ballkani duhet të jetë pjesë e BE-së!” *Panorama*, 18 qershor 2022.

“European Union Has Forgotten the Purpose of Its Existence, Rama Tells FT”. *Exit.al*. Marrë nga: <https://exit.al/en/2021/05/13/european-union-has-forgotten-the-purpose-of-its-existence-rama-tells-ft/>

Gjipali, Gledis. 2022. “Lufta në Ukrainë dhe ndikimi në antarësimin e Ballkanit në BE”. *Transition Promotion Program*. *Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Gjonaj, Arlinda. 2020. Investimet nga Emiratet e Bashkuara Arabe, 40 milionë euro gjatë vitit 2020. ATA (Agjencia Telegrafike Shqiptare), 3 dhjetor. Marrë nga: <http://ata.gov.al/2020/12/03/investimet-nga-emiratet-e-bashkuara-arabe-40-milione-euro-gjate-vitit-2020/>

“Gjuha e pavend e Edi Ramës kundër Bullgarisë”. *Gazeta Tema*. 23 Qershor. Marrë nga: <https://www.gazetatema.net/blogu-tema/gjuha-e-pavend-e-edi-rames-kunder-bullgarise-i344074>

Gladstone, Rick. 2020. How the Cold War Between China and U.S. Is Intensifying. *New York Times*. July 22. <https://www.nytimes.com/2020/07/22/world/asia/us-china-cold-war.html>

Grabbe, Heather and Stephen Lehne. 2018. “Could an Illiberal Europe Work?” *Carnegie Endowment for International Peace*.

Haddad, Benjamin and Damir Marusić. 2021. "The Balkans Don't Believe the EU Anymore." *Foreign Policy*. 25 gusht. Marrë nga: <https://foreignpolicy.com/2021/08/25/balkans-dont-believe-eu-anymore-albania-macedonia-rama-vucic/>

Historiku i marrëdhënieve BE-Shqipëri. Retrieved from: <https://www.trt.net.tr/shqip/rubrikat-tematike/2014/06/24/historiku-i-marredhenieve-be-shqiperi-105885> 29 Prill 2022

"Historike/ Shqipëria çel negociatat! BE: Me Tiranën bëhemi më të plotë! Rama: Evropa fati ynë, vijmë sot këtu pas një pune të gjatë! Integrimi e bën Ballkanin më të mire". 2022. *Shqiptarja*. 19 korrik. <https://shqiptarja.com/lajm/sot-mbahet-konferenca-e-pare-nderqeveritare-shqiperibe-vrapi-i-fundit-drejt-anetaresimit-te-plote>

Hoxhaj, Andi. 2022. "Ndikimi i Rusisë në Ballkan po rritet pikërisht kur po cenohet paqja e brishtë e rajonit". *CNA*. 19 korrik. <https://www.cna.al/opinione/ndikimi-i-rusise-ne-ballkan-po-rritet-pikerisht-kur-po-cenohet-paqja-e-i320371>

"Ja çfarë fshihet pas investimit 2 miliard euro në Portin e Durrësit". 2021. *Gazeta Telegraf*. 21 qershor. Marrë nga: <https://telegraf.al/ekonomi/ja-çfare-fshihet-pas-investimit-2-miliard-euro-ne-portin-e-durresit/>

Kajsiu, Blendi. 2022. "Antarësimi në BE si rrezik për demokracinë shqiptare". *Transition Promotion Program*. *Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Kalemaj, Ilir. 2022. "Russia's irredentism and the existence of Ukraine as a nation-state". *A2 CNN*. 4 mars. <https://english.a2news.com/2022/03/04/russias-irredentism-and-the-existence-of-ukraine-as-a-nation-state/>

Kalemaj, Ilir. 2022. Ballkani Perëndimor i disa shpejtësive. *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Kamberi, Geron. 2022. “Në kërkim të kohës së (pa)humbur të integritit në BE”. *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Krisafi, Ledion. 2022. “Efektet e shumëfishta të zvarritjes së procesit të integritit”. *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

Kryeziu, Erisa. 2022. “Shqipëria merr renditjen më të ulët historike në Indeksin e Lirisë së Medias”. *Citizens Channel*. 3 Maj. Marrë nga: <https://citizens-channel.com/2022/05/03/shqiperia-merr-renditjen-me-te-ulet-historike-ne-indeksin-e-lirise-se-medias/>

Kushi, Sidita. 2022. “Comment: Don’t Compare Russia’s War to NATO in Kosovo”. *Exit.al* 1 mars. [Comment: Don’t Compare Russia’s War to NATO in Kosovo - Exit - Explaining Albania](#)

Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian. MEPJ. Marrë nga: <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

Marukic, Sinisa Jakov. 2010. “Report: Saudis Fund Radical Islam In Balkans”. *Balkan Insight*, 29 Mars. Marrë nga: <https://balkaninsight.com/2010/03/29/report-saudis-fund-radical-islam-in-balkans/>

McGluynn, Jade. 2022. “Pse Putin vazhdon të flasë për Kosovën”? *Bota.al*. 5 mars. [Pse Putin vazhdon të flasë për Kosovën? – bota.al](#)

“Mercenarë nga Shqipëria dhe Kosova po rekrutohen për luftën në Donbas”, Pandeli Majko reagon pas deklaratës së Lavrov: Ambasada ruse të japë shpjegime”. 2022. *Gazeta Tema*. 22 shkurt. Marrë nga: [“Mercenarë nga Shqipëria dhe Kosova po rekrutohen për luftën në Donbas”, Pandeli Majko reagon pas deklaratës së Lavrov: Ambasada ruse të japë shpjegime - Politika \(gazetatema.net\)](https://www.gazetatema.net/mercenare-nga-shqiperia-dhe-kosova-po-rekrutohen-per-lufte-n-donbas)

Mërtiri, Leonidha. 2022. “Rezultate apo thjesht ecejake”. *Gazeta Panorama*. 11 Qershor. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/rezultate-apo-thjesht-ecejake/>

Minxhozi, Skënder. 2022. “Çifti i çuditshëm shqiptaromaqedon/ Na duan bashkë që të na lenë jashtë?!” *Transition Promotion Program. Instituti Shqiptar i Medias*. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>

“Mos e bëni”/ Rama i vendosur të kërkojë ndarjen nga Maqedonia e Veriut nëse nuk pranohet propozimi i Macron: Dera e BE duhet të hapet”. *Gazeta Panorama*. 4 korrik. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/mos-e-beni-rama-i-vendosur-te-kerkoje-ndarjen-nga-maqedonia-e-veriut-nese-nuk-pranohet-propozimi-i-macron-dera-e-be-duhet-te-hapet/>

Murati, Shaban, 2022. “Shaban Murati: A ka mundësi që rreziku i një kërcënimi rus të përshpejtojë proceset integruese në BE të Ballkanit?” 2022. *Albspirit*. Marrë nga: <https://alb-spirit.com/2022/02/26/shaban-murati-ka-mundesi-qe-rreziku-nje-kercenimi-rus-te-pershpejtoje-proceset-integruese-ne-te-ballkanit/>

Murati, Shaban. 2022. “Rreziku rus në portat e Ballkanit: Një celës e ka dhënë Tirana”. *Gazeta Dita*.

“Negociatat/ Kalemaj: Jam skeptik nuk jemi gati, asnjë kusht i përmbushur plotësisht”. 2022. *MCN Tv*. 19 korrik. <http://www.mcntv.al/2022/07/19/negociatat-kalemaj>



[jam-skeptik-nuk-jemi-gati-asnj-kusht-i-p-rmbushur-plot-sisht?fbclid=IwAR24ODWH4G0gcgGlfhyZgn0tW4XJr-Ferdq1UfzZ7Mo9A8FaakJlz-JENNA](https://www.facebook.com/1wAR24ODWH4G0gcgGlfhyZgn0tW4XJr-Ferdq1UfzZ7Mo9A8FaakJlz-JENNA)

“Open Balkan”, Rama tallet me BE: Më vjen keq kur i shoh në Bruksel, i jap kurajo”. 2022.*Boldnews*. 8 Qershor. Marrë nga: <https://boldnews.al/2022/06/08/open-balkan-rama-tallet-me-be-me-vjen-keq-kur-i-shoh-ne-bruksel-i-jap-kurajo/>

Qalliu, Bledar. 2020. “Rama Blames the EU for Albania’s Lack of Covid-19 Vaccine”. *Exit News*. [Rama Blames the EU for Albania’s Lack of Covid-19 Vaccine - Exit - Explaining Albania](https://www.exitnews.com/rama-blames-the-eu-for-albanias-lack-of-covid-19-vaccine/)

“Përse Shqipëria nuk po ndahet nga Maqedonia e Veriut?” 2022. *Shqiptarja*. 26 Qershor. Marrë nga: <https://shqiptarja.com/lajm/perse-shqiperia-nuk-po-ndahet-nga-maqedonia-e-veriut>

Pollo, Genc. 2022. “Sërish për Shqipërinë në Evropë, por në rrethana të ndryshuara”. *Gazeta Panorama*. 30 Maj. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/1168112-2/>

Pollo, Genc. 2021. “Procesi apo rezultati?” *Gazeta Panorama*. 12 Prill. Marrë nga: [Procesi apo rezultati? \(panorama.com.al\)](https://www.panorama.com.al/procesi-apo-rezultati/)

Prifti, Juliana. 2022. “Rama: Shqipëria dhe SHBA, bashkëpenëmbajtëse të çështjes së Ukrainës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së”. 5 shkurt. *Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATA)*. Marrë nga: <https://ata.gov.al/2022/02/05/rama-shqiperia-dhe-shba-bashkepenembajtese-te-ceshtjes-se-ukraines-ne-keshillin-e-sigurimit-te-okb-se/>

“Protesta në Tiranë kundër sulmit rus në Ukrainë, i riu për Report Tv: Mund të strehoj një familje ukrainase.” 2022. *Report Tv*. 27 shkurt. Marrë nga: [Protesta në Tiranë kundër sulmit rus në Ukrainë, i riu për Report Tv: Mund të strehoj një familje ukrainase - Report-tv.al](https://www.reporttv.al/protesta-ne-tirane-kunder-sulmit-rus-ne-ukraine-i-riu-per-report-tv-mund-te-strehoj-nyje-familje-ukrainase-report-tv-al)

Putin’s national security secretary, Nikolai Patrushev, to

visit Belgrade. Retrieved from: <https://www.telegraf.rs/english/3461180-putins-national-security-secretary-nikolai-patrushev-to-visit-belgrade> 21 Februrary 2022.

Rakaj, Alfons. 2021. "Vrapiminë drejtim të gabuar: Pakënaqësia e Ramës nga BE-ja në lidhje me vaksinimin është rezultat i nervozës në rritje". *Sbunker*. 8 shkurt. Marrë nga: <https://sbunker.net/histori-nga-rajoni-3-bllogje-tematike/90818/vrapimi-ne-drejtim-te-gabuar-pakenaqesia-e-rames-nga-be-ja-ne-lidhje-me-vaksinimin-eshte-rezultat-i-nervozes-ne-rritje/>

"Rama zbardh fjalimin që mbajti dje në samitin e Brukselit: Në Shqipëri, të gjithë i besojnë Europës! Mos lini që ky besim të bjerret pa kthim". 2022. *Shqiptarja*. 24 qershor. Marrë nga: <https://shqiptarja.com/lajm/rama-zbardh-fjalimin-qe-mbajti-dje-ne-samitin-e-brukselit>

"Russia checking reports about mercenaries for Donbass from Kosovo, Albania, B&H — Lavrov". 2022. TASS: Russian State Agency. 22 Shkurt. Marrë nga: [Russia checking reports about mercenaries for Donbass from Kosovo, Albania, B&H — Lavrov - World - TASS](https://tass.com/world/2022/02/22/russia-checking-reports-about-mercenaries-for-donbass-from-kosovo-albania-b-h-lavrov)

"Rusia dëbon një diplomate shqiptare". 2021. Radio Evropa e Lirë. 8 shkurt. Marrë nga: <https://www.evropaelire.org/a/31092176.html>

Seaman, John et al. eds. 2017. *Chinese Investment in Europe: A Country Level Approach*. French Institute of International Relations (*Ifri*), Elcano Royal Institute, Mercator Institute for China Studies.

"Sondazh i opinionit publik: Besimi në qeverisje." 2016. IDM. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2016-AL.pdf>

Soreca: I habitur nga kritikak e Ramës ndaj BE-së për vaksinën. 2021. A2. 12 janar. Marrë nga: <https://a2news.com/2021/01/12/soreca-per-zerin-e-amerikes-i-habitu-nga-kritikat-e-rames-per-vaksinën/>

“Studimi i AIIS-së: 49.1% e shqiptarëve ‘PO’ marrjes së statusit në qershor”. 2014.

*InfoArkiva: Arkiva Mediatike Shqiptare.* Marrë nga: <http://www.arkivalajmeve.com/Studimi-i-AIIS-se-491-e-shqiptareve-lsquoPOrsquo-marrjes-se-statusit-ne-qershor.1047597194/>

Tadic, Danijel. 2017. “Lack of good governance contributes to growth of radical Islam in the Western Balkans”. *Clingedael Spectator* 4, Vol. 71. Marrë nga: <https://spectator.clingendael.org/pub/2017/4/the-growth-of-radical-islam/>

Taylor, Alice. 2022. What Ukraine’s EU Membership Bid Means for the Western Balkans. *Exit.al*. 19 mars. [What Ukraine’s EU Membership Bid Means for the Western Balkans - Exit - Explaining Albania](#)

“Vaksina anti-Covid edhe për Kosovën”/ Rama i indinjuar me BE-në: Si europian jam ndjerë i turpëruar, vendimarrje absurde dhe e papranueshme...” 1 Janar 2021. Panorama newspaper. “Vaksina anti-Covid edhe për Kosovën”/ Rama i indinjuar me BE-në: Si europian jam ndjerë i turpëruar, vendimarrje absurde dhe e papranueshme... (panorama.com.al)

Vuksanović, Vuk. 2021. “Serbia’s best friend in the Arab World: the UAE”. 9 korrik. Marrë nga: <https://www.mei.edu/publications/serbias-best-friend-arab-world-uae>

Zeneli, Valbona. 2019. “Kina në Ballkan”. 13 prill. *Gazeta Panorama*. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/kina-ne-ballkan-2/>

Zeneli, Valbona. 2019. "China in the Balkans: Chinese investment could become a challenging factor for the European future of the Western Balkans." *The Globalist*. Shih për më tepër: <http://europa.com.al/index.php/2020/11/06/influenca-e-kines-ne-ballkanin-perendimor/>

*The place of North Macedonia in China's strategy for the Western Balkans*. Konrad Adenauer Stiftung. [www.kas.de](http://www.kas.de)

Zogaj, Prec. 2022. "Fundi i një frustrimi, fillimi i një ere të re". *Transition Promotion Program*. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/transition-promotion-program/>